Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 10 (42). TETOR 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

INTERVISTË

A mposhten tërmetet?

Flet **Hajri Hoxha**

Nga: **ABDURRAHIM ASHIKU** - FAQE 5

REPLIKË

Lëreni të bukur luginën e Drinit të Zi...

Nga: **MURAT KOLTRAKA** - FAQE 6

TEATRI

"Skampa" fiton titullin "S.Pitarka"

Nga: **REXHEP TORTE** - FAQE 13

SPORT

Duka, ylli i SHBA në Kupën e Botës

Nga: **BEQIR SINA** - FAQE 9

OPINION

"Zgjidhje me zinxhirë"

Nga: **BUJAR KAROSHI**

"Një skandal shënohet në Maqellarë të Dibrës. Dy motrat 47 dhe 38 vjeçe Thëllënxa dhe Fidane Keshi mbahen prej plot 22 vjetësh të lidhura nga babai. Me flokë të prerë keq, dhëmbë të prishur dhe të tulatura ato jetojnë në robëri. Fotot paraqesin njërën prej tyre dhe policia tek banesa e robërisë. 70 vjeçari Dine Keshi, babai i motrave ka bërë të ditur se të bijat janë agresive dhe rrezik për banorët ndaj është detyruar ti lidhë. Babai shpjegon se vajzat vuajnë nga problemet mendore, por pavarësisht kësaj nuk mjekohen. Vajzat jetojnë vetëm me babain në kushte të mjerueshme ekonomike, pasi nëna ka vite që u ka vdekur". Me këtë tekst shoqëronte fotografitë e ngjarjes "balkanweb.com". Dhe më shumë se kaq nuk mund të shkruash për këtë ngjarje. Çfarëdo që të thuash ke përsëritur vetveten. Por, nuk të paraqitet e njëjtë pamja nga ajo që përcjellin mediat dhe ajo që vjen nga Maqellarë, nga shtëpia e Thellënxës dhe Fidanes, që "e shijojnë" jetën në antonimin e kundërt të emrave të tyre.

"Dy motra jetojnë të lidhura me zinxhirë për 22 vite rresht", ishte skupi mediatik, sikur kish ndodhur gjema. Gjithë gazetat dhe televizionet, pavarësisht përshkrimit emocional, fjalinë e mësipërme e kishin të njëjtë. Ai ishte lajmi. Çdo lloj përshkrimi rreth këtij lajmi ishte i justifikuar.

Por, media, si gjithmonë, dhe sidomos këto vitet e fundit, asnjëherë nuk është marrë me problemin, por me detajet e këndshme për dëgjuesin e lexuesin. Gazetarët e përshkruan lajmin e lidhjes me zinxhirë si ngjarje e rrallë. Por harruan edhe një detaj "mediatik" të momentit: A kanë votuar Thëllënxa dhe Fidania? (Lëre më mirë, për këtë duhen hapur kutitë dhe kështu dalim jashtë teme). Nuk po shtojmë këtu, që sipas bashkëmoshatarëve të Fidanes, ajo e ka kryer shkollën e mesme me rezultate të shkëlqyera...

(Vijon në faqen 2)

KËSHILLI TEKNIK NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE VENDOS TË NDRYSHOJË PROJEKTIN PËR RRUGËN E ARBËRIT

Asfalti nga 9 metra do të bëhet 7



Ndryshimet do të bëhen jo vetëm në segmentin Ura e Vashës - Ura e Brarit, por edhe segmentin në të cilin po punohet aktualisht, atë nga Bulqiza te Ura e Vashës. Ndërkohë që dy lote të këtij segmenti janë tenderuar dhe firmat fituese po punojnë.

Ndryshimet për keq në Rrugën e Arbërit janë "gurë nën rrota" kundër zhvillimit infrastruktur-or në vend, kundër zhvillimit të vendit dhe integrimit të Shqipërisë. Kështu, është koha që çdo njeri i përgjegjshëm në këtë vend, i thjesht apo me autoritet, i papunë apo me poste, drejtues komuna e bashkie apo deputet, etj., të ushtrojë të gjithë të drejtat që i jep statusi civil apo zyrtar, për të korrigjuar gabimet në Rrugën e Arbërit, në mënyrë që nesër të mos kemi një rrugë dykalimshe, por një autostradë të integrimit të Shqipërisë.

(Lexoni në faqet 2,3)

SPECIALISTI

Tregjet bujqësore dhe panairet e agro-bisnesit

Nga: **DALI HORESHKA** - FAQE 8

PROFIL

Nga rreziku i burgut, në lirinë e suksesit

Me biznesmenin dibrano-amerikan, **ARTUR PIRA** - FAQE 7

KUJTESË

Elegji për Musa Sinën

Nga: Prof. as. Dr. **BAJRAM XHAFA** - FAQE 14

NJOFTIM

Njoftohen anëtarët e Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" se më datë 14 nëntor 2009, do të zhvillohet Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës. Më shumë informacion informohuni pranë sekretarisë së shoqatës.

Posta e Rruga Arbërit


Gazetë e pavarur.
Nr. 10 (42). 1- 31 Tetor 2009

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Isa Halilaj, Mahmud Hysa, Rexhep Ndreu, Haki Kola, Xhelal Roçi, Abdurahim Ashiku, Beqir Sina, Odise Plaku, Saimir Shatku, Vesel Hoxha, Kujtim Boriçi, Dukagjin Hata, etj, se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:
Rexhep TORTE
Xhafer MARTINI
Bajram XHAFA
Dali HORESHKA
Abdurahim ASHIKU
Murat KOLTRAKA
Naim PLAKU
Afrim KAROSHI
Beqir SINA
Zabit LLESHI
Vojsava LEKA

etj.

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë



Shtëpia e Dine Keshit. Foto. Balkanweb.com

"Zgjidhje me zinxhirë"

(Vijon nga faqja 1)

Ngjarja vërtet ishte makabre, por "lidhja me zinxhirë" në raste të tilla nuk është një skup. Edhe në institucionet ku Thëllënxa dhe Fidanja u strehuan, dhe në institucionet e tjera të ngjashme, të lidhur në mos me zinxhirë, me litarë të lidhur mbahen. Por nuk janë të ndryshkur, janë të nikeluara, të pastra. Në mos të lidhur, mbahen të izoluar, si në burg, por ato janë në spital.

Thëllënxa dhe Fidania 22 vjet të lidhura. Në mos me zinxhirë, të mbajtura nën kontroll gjithë kohën. Njëra prej vajzave, Thëllënxa, ka qenë e shtruar në spitalin e Vlorës, por e nxorën. Të voglën babai nuk e çoi fare në spital. Pse ta çonte? Njerëzit e fisit, të fshatit, të komunitetit, institucionet lokale dhe shëndetësore nuk bënë asgjë për dy vajzat. Një kryeplak fshati dënohet në qoftë se një trafikant mbjell hashash në tarracën e shtëpisë së tij, por askush nuk mban përgjegjësi në qoftë se dy "të çmendura" kërcënojnë komunitetin; banorët, fëmijët... Imagjinoni që Thëllënxa dhe Fidania ti ishin vërsulur ndonjë djali apo vajze të vogël. Ta kafshonin... të rrihnin... Ndoshta skupi mediatik do ishte më i madh: "Dy të çmendura dhunojnë një fëmijë"...

Rasti i vajzave nga Maqellara nxjerrin në dritë një problem shoqëror: bashkëjetësen e njerëzve normale me të sëmurët mendore, të cilët shpesh herë janë të rrezikshëm, të dhunshëm. Ata nuk lejojnë familjen dhe komunitetin rreth tyre të jetojnë të lirë. Çfarë duhet të bëjë një familje që ka fatin e zi të ketë në gjirin e saj një të sëmurë të tillë? Familjarët jetojnë nën dhunën e tyre. I çojnë në spitale por pas pak ditësh i kthejnë mbrapsht si kolipostë e parapaguar. Shërbimet sociale në Shqipëri vetëm evidentojnë rastet. Punonjësit socialë në pushtetin vendor, çdo punë bëjnë, por atë për të cilën paguhen nuk e bëjnë dot. Ç'u duhet, rrogën e marrin. Institucionet shëndetësore nuk i marrin në mbrojtje: njerëz pa krah, nuk japin ryshfet. Organizatat humanitare nuk mund ti marrin në mbrojtje: Janë në minorancë, nuk përmbushin kriteret për të fituar projekte (nënkupto: para).

Në këto kushte familjarët gjejnë zgjidhjen që vjen nga shekujt: "I lidhin në trupa". Sot kanë zinxhirë!

Kush është babai i tyre, Dine Keshi? Një ish-i burgosur... "Babain e vajzave e kam njohur në kampin e Spaçit, në vitet 1978 - 1982. Dënohet si ordiner në vitet 1976 dhe dërgohet në kampin e të burgosurve ordinerë në Bulqizë. Pas ca kohësh, Dinia, me zgjuarsinë natyrale të fashatarit dhe me cinizëm e marifet tallej me regjimin Enver Hoxhës dhe dënohet përsëri në kampin e Bulqizës për agjitacion e propagandë ndaj Partisë së Punës dhe Enver Hoxhës me dhjetë vjet të tjera. Pastaj e sjellin në kampin e të burgosurve politikë, në Spaç të Mirditës, ku punonte në minierë. Kam mësuar nga kontaktet me të, se fëmijët i kishte të vegjël në moshë,

> Dine Keshit nuk i është ndarë zinxhiri nga dora gjithë jetën. Kur e arrestuan rreth 40 vjet më parë, zinxhiri e kishte fajin. Po ashtu në burg, zinxhirin e ka mbajtur gjithmonë në këmbë e duar, nga frika e arratisjes. Tani në pleqëri ua dha vajzave. Ndoshta, për herë të fundit për të mirë: si gjetje simbolike për ti shpëtuar ato nga varfëria... N.q.s është kështu, përpara se "ta lidhim në trupa", duhet ta urojmë për zgjidhjen e munguar nga strukturat shoqërore e institucionale të kësaj shoqërie, zgjidhje që e gjeti në zinxhirët e vuajtjeve të tij.

se gruan e kishte të sëmurë rëndë dhe se asnjëherë nuk i ka ardhur për ta takuar në Spaç. Dine Keshi duhet të jetë liruar nga viti 1988 apo 1991 nga Burgu, me pak fjalë, nuk ka pasur kohë të merret me fëmijët e tij", shkruante një qytetar në faqet e gazetës Shekulli online.

Një punonjës i ndihmës mjekësore që shkoi në vendngjarje tha korrespondentit tonë "se kishte disa ditë që nuk flinte. Ishte tmerruar nga pamja që kishte parë. Ishte tronditur. "Kushtet në atë shtëpi ishin skandaloze. Krevati ishte i kalbur, me dërrasa druri. Në vend të dyshekut kishin kashtë, si ajo që u hidhet bagëtive. Një batanije në qoshe të krevatit. Babai i lante dhe i ushqente me çfarë mundej". "Kur i morëm vajzat, unë pashë plakun të qante, tha një punonjës policie. Në ato momente mu duken si lot lehtësimi dhe mallëngjimi".

Dines nuk i është ndarë zinxhiri nga dora gjithë jetën. Kur e arrestuan rreth 40 vjet më parë, zinxhiri e kishte fajin. Po ashtu në burg, zinxhirin e ka mbajtur gjithmonë në këmbë e duar, nga frika e arratisjes. Tani në pleqëri ua dha vajzave. Ndoshta, për herë të fundit për të mirë: si gjetje simbolike për ti shpëtuar ato nga varfëria... N.q.s është kështu, përpara se "ta lidhim në trupa", duhet ta urojmë për zgjidhjen e munguar nga strukturat shoqërore e institucionale të kësaj shoqërie, zgjidhje që e gjeti në zinxhirët e vuajtjeve të tij.

B.K.

Nga: **BUJAR KAROSHI**

Ndryshime teknike në Rrugën e Arbërit, por jo për të rritur cilësinë e saj, por për ta ulur atë. Në kohën kur Shqipëria ndodhet vetëm një hap drejt integrimit të strukturat europiane, drejtues të Ministrisë së Transporteve urdhërojnë ndryshime teknike në dëm të Rrugës së Arbërit. "Ne besojmë se vetëm një Shqipëri me infrastrukturë moderne, një Shqipëri e cila lufton për një klimë biznesi, një Shqipëri që instalon revolucionin industrial dhe e zhvillon atë me shpejtësi, do të mund të punësojë shqiptarët. Rruga e Arbërit është rruga e Shqipërisë europiane, korridori i kombit është korridori i Shqipërisë europiane. Ju garantoj se në 2 vjet kjo rrugë do të kapë Tiranën dhe ju do të zbrisni në Tiranë në një kohë prej 40 deri në 60 minuta", ka thënë Kryeministri Sali Berisha në një takim me banorët e Peshkopisë, vetëm afro 2 muaj pas zgjedhjeve të 28 qershorit. Por nuk kalojnë as dy muaj të tjerë, gjatë një mbledhje të Këshillit Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugës, është dhënë urdhri që hartuesit e projektit teknik të Rrugës së Arbërit të bëjnë ndryshime në projekt.

Burime të gazetës thanë **se "Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ka kthyer mbrapsht projekti teknik të Rrugës së Arbërit në segmentin nga Ura e Vashës në Tiranë, duke kërkuar që në të të bëhen ndryshime teknike. Ndryshimet konsistojnë në zvogëlimin e gjerësisë së rrugës së asfaltuar nga 9 metra në 7 metra.** Një urdhër i tillë vjen pas një mbledhje të Këshillit Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, ku ka qenë i pranishëm edhe zv.ministri i transporteve. Burimet e gazetës thanë se vendimi është i pajustifikuar dhe i paargumentuar.

Ne kontaktuam me drejtuesin e firmës "Infratransprojekt", z. Faruk Kaba, i cili po merret me studimin teknik të rrugës, por ai tha se po punonte për projektin. Kaba tha gjithashtu se ai po i jepte dorën e fundit projektit dhe shpresonte ta dorëzonte atë sa më shpejt.

Por, burimet e gazetës nga Drejtoria e Përgjithshme rithekksuan se gjatë mbledhje është kërkuar ndryshimet në projekt nga zv. ministri i Transporteve, dhe se përveç kësaj, i janë kërkuar projektuesit të bëjë edhe **ndryshimet jo vetëm në segmentin Ura e Vashës - Ura e Brarit, por edhe segmentin në të cilin po punohet aktualisht, atë nga Bulqiza te Ura e Vashës. Ndërkohë që ky segment është tenderuar dhe firmat fituese po punojnë.**

Vendimet e marra në Këshillin Teknik , jo vetëm që bien ndesh me dëshirën e shqiptarëve, por ajo bie ndesh edhe me premtimet e Ministrit të Transporteve

e ditës



Ndryshimet për keq në Rrugën e Arbërit janë "gurë nën rrota" kundër zhvillimit infrastrukturor në vend, kundër zhvillimit të vendit dhe integrimit të Shqipërisë. Kështu, është koha që çdo njeri i përgjegjshëm në këtë vend, i thjesht apo me autoritet, i papunë apo me poste, drejtues komuna e bashkie apo deputet, etj., të ushtrojë të gjithë të drejtat që i jep statusi civil apo zyrtar, për të korrigjuar gabimet në Rrugën e Arbërit, në mënyrë që nesër të mos kemi një rrugë dykalimshe, por një autostradë të integrimit të Shqipërisë.

Asfalti nga 9 metra në projekt do të bëhet 7 metra

Këshilli Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve vendos të ndryshojë projektin për Rrugën e Arbërit

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ka kthyer mbrapsht projekti teknik të Rrugës së Arbërit në segmentin nga Ura e Vashës në Tiranë, duke kërkuar që në të të bëhen ndryshime teknike. Ndryshimet konsistojnë në zvogëlimin e gjerësisë së rrugës së asfaltuar nga 9 metra në 7 metra.

Ndryshimet do të bëhen jo vetëm në segmentin Ura e Vashës - Ura e Brarit, por edhe segmentin në të cilin po punohet aktualisht, atë nga Bulqiza te Ura e Vashës. Ndërkohë që dy lote të këtij segmenti janë tenderuar dhe firmat fituese po punojnë.

Sokol Olldashi dhe kryeministrit të vendit, Sali Berisha.

Ministri i Transporteve Sokol Olldashi, një muaj para zgjedhjeje të përgjithshme parlamentare, më 11 maj 2009, në një takim madhështor në Pallatin e Kongreseve deklaroi se "brenda këtij viti do tenderohen tre lote të tjera nga Bulqiza deri të Ura e Vashës dhe një lot nga Tirana drejt urës së Brarit. Do të mbetet një lot i fundit nga Ura e Brarit te Ura e Vashës ku përfshihet edhe një urë që është vepër arti, një urë që është shumë komplekse dhe që do marrë pak më shumë kohë. Sot nuk besoj të flitet më nëse është Rruga e Arbërit apo nuk është Rruga e Arbërit. Rruga e Arbërit avancon çdo ditë, është tashmë një realitet dhe unë kam pasur fatin të jem ministër i Punëve Publike, **kur kryeministri i këtij vendi ka marrë vendimin politik për ta ndërtuar këtë rrugë, pavarësisht kostos financiare".**

Po ashtu Rruga e Arbërit ka qenë një nga pikat kryesore të Kryeministrit gjatë fushatës elektorale. Por edhe pas fushatës, Kryeministri Berisha në një takim me banorët e Peshkopisë, gjatë inagurimit të një segmenti të Rrugës, tha se "Rruga e Arbrit është shndërrimi në realitet i një ëndrre të banorëve të këtyre zonave, të të gjithë shqiptarëve të trevave të tjera, të lidhura shpirtërisht dhe pazgjidhshmërisht me Dibrën, me Tiranën dhe mbarë Shqipërinë". **"Rruga e Arbrit shumëfishon marrëdhëniet tregtare dhe marrëdhëniet e gjithanshme me Maqedoninë mike, bën që gjithë portet e Shqipërisë të bëhen gjithnjë e më të përzgjedhur e më të përshtatshme, për Maqedoninë dhe për Bullgarinë perëndimore. Rruga e Arbrit do të jetë rruga e fluksit të madh turistik".**

Jo vetëm gjatë dhe pas fushatës elektorale, por edhe disa ditë më parë, Kryeministri e vuri theksin te infrastruktura rrugore, veçanërisht të Rruga e Arbërit. "Duke ruajtur dhe konsoliduar një nivel shumë të lartë investimesh, janë projekte të mëdha të cilat shqiptarët mezi presin t'i shohin të zbatuar. Janë Rruga e Arbrit, ëndrra e qytetarëve të Elbasanit për t'u lidhur me tunel me qytetin e Tiranës, Boshti i Jugut dhe një seri projektesh të mëdha. Në një mandat katër vjeçar ne do të asfaltojmë 7 mijë kilometra rrugë; autostrada, rrugë kombëtare, rrugë rurale, rrugë dytësore në fshatra dhe qytete. Projekti ynë për një Shqipëri tjetër do të vazhdojë me agresivitetin më të lartë", tha kryeministri Berisha në takimin e Komitetit të Planifikimit të Strategjive, më datë 27 tetor, i cili mori në shqyrtim projektbuxhetin për vitin 2010- të.

Por a është në dijeni kryeministri për ndryshimet e fundit që po i bëhen projektit?

Burimet e gazetës thanë se nuk besonin se kryeministri kishte informacion mbi çështjet teknike të rrugës, duke lënë të kuptohej se këto ndryshime po ndodhnin vetëm për arsyen e kostos së lartë financiare.

Një specialist në projektimin dhe ndërtimin e rrugëve tha se **ndryshimi i gjerësisë së asfaltit nga 9 metra, përfshirë bankinat, në 7 metra, nuk sjell ulje të madhe të kostos së ndërtimit. Maksimumi, kjo mund të kursejë rreth 10% të investimit,** ose për rastin konkret deri në 30 milionë euro., kosto e papërfillshme në perspektivën rajonale të infrastrukturës rrugore.

Por, ky argument bie poshtë në rastin e Rrugës së Arbërit, pasi është i vetmi segment rrugor në vend, financimet e të cilit janë pothuajse të garantuara.

Siç është njoftuar edhe më parë nëpërmjet gazetës "Rruga e Arbërit" apo media të ndryshme, investitorë të ndryshëm, italianë, gjermanë, austriakë, turq, etj, kanë shfaqur herë pas here interesim për të investuar në Rrugën e Arbërit në forma të ndryshme investimi, duke përfshirë koncesionin apo forma të ndërmjetme investimi mes koncesionit dhe investimeve nga buxheti.

Ishte Kryeministri Sali Berisha që priti në fillim të muajit gusht presidentin e kompanisë turke TAT Group- Devel.Center, Dr Mehmet Tatlici. Në këtë takim, kompania turke prezantoi projekt propozimet për investime në fushën e energjisë së rinovueshme, në transportin rrugor dhe në turizëm. Ndërkohë që kërkojnë të marrin me koncesion ndërtimin e Rrugës së Arbërit si dhe ndërtimin e rrugës Tiranë-Elbasan. Në këtë kuptim, kursimi prej 10% të shpenzimeve në Rrugën e Arbërit do ta nxirrnin të pavlefshëm në planin afatshkurtër ndryshimet në cilësinë e rrugës.

Rruga e Arbërit, si asnjë investim tjetër në Shqipëri në këto 20 vite pluralizëm, është një investim i kërkuar me ngulm nga njerëzit e përgjegjshëm të këtij vendi. Janë individë, shoqata, institucione që gjatë këtyre viteve kanë pasur si kryefjalë ndërtimin e rrugës, si një mundësi e integrimit rajonal të rajonit të Dibrës, Matit, Tiranës dhe shqiptarëve të Maqedonisë. Rruga e Arbërit është segmenti që lidh më shkurtër shtetet e bashkësisë Europiane, Bullgarisë me pjesën tjetër të perëndimit. "Vënia në shfrytëzim e kësaj rruge do të ketë një impakt të jashtëzakonshëm, jo vetëm për Dibrën, por edhe për trevat e banuara nga shqiptarët në Maqedoni, për zonën e Matit pa përjashtim, për Tiranën, Durrësin e të gjithë vendin. Pasuritë e jashtëzakonshme të trevave të Dibrës andej dhe këtej kufirit do të vihen në lëvizje si kurrë më parë. Sofja, kryeqendra e Bullgarisë, me rrugën e Arbërit bëhet me afër me Durrësin, pra me detin Adriatik se sa me Detin e Zi. Në kushtet e një Europe të bashkuar dhe pa kufij, kjo është shumë domethënëse" ka thënë Ing. Faruk Kaba, në një intervistën për gazetën numrin e kaluar.

Në këto kushte, **ndryshimet për keq në Rrugën e Arbërit janë "gurë nën rrota" kundër zhvillimit infrastrukturor në vend, kundër zhvillimit të vendit dhe integrimit të Shqipërisë. Kështu, është koha që çdo njeri i përgjegjshëm në këtë vend, i thjesht apo me autoritet, i papunë apo me poste, drejtues komuna e bashkie apo deputet, etj., të ushtrojë të gjithë të drejtat që i jep statusi civil apo zyrtar, për të korrigjuar gabimet në Rrugën e Arbërit, në mënyrë që nesër të mos kemi një rrugë dykalimshe, por një autostradë të integrimit të Shqipërisë.**

SPECIALISTËT: ndryshimi i gjerësisë së asfaltit nga 9 metra, përfshirë bankinat, në 7 metra, nuk sjell ulje të madhe të kostos së ndërtimit. Maksimumi, kjo mund të kursejë rreth 10% të investimit.

Kryeministri SALI BERISHA: "Rruga e Arbrit shumëfishon marrëdhëniet tregtare dhe marrëdhëniet e gjithanshme me Maqedoninë mike, bën që gjithë portet e Shqipërisë të bëhen gjithnjë e më të përzgjedhur e më të përshtatshme, për Maqedoninë dhe për Bullgarinë perëndimore. Rruga e Arbrit do të jetë rruga e fluksit të madh turistik".

Ministri i Transporteve, SOKOL OLLDASHI: Kryeministri i këtij vendi ka marrë vendimin politik për ta ndërtuar këtë rrugë, pavarësisht kostos financiare". *(11 maj 2009, Pallati i Kongreseve)*

Rruga Arbërit nr. 42

aktualitet



Peshkopia, oaz vlerash

Nëse do niseshim nga Gëtja dhe disa mend je të ndritura botërore ne do të ishim qytetarë të botës. Sipas këndvështrimit tim ne jemi pjesë e botës dhe e përbëjmë botën, por para se të jemi qytetarë të botës jemi qytetarë të një njësie që bota përmban.

Në fund të fundit diçka e themi me bindje: Bota funksionon falë këtyre njësive që quhen vende në përgjithësi dhe vendlindje në veçanti. Bëhet fjalë për vendin me të cilin identifikohemi deri sa të rreshtim të marrim frymë.

Për këtë identitet që na jep i jemi mirënjohës dhe meriton tërë vlerësimet, përpjekjet, sakrificat, përkushtimin, veprën dhe qenien tonë për t'i dhënë një post të privilegjuar në fronin mbretëror të quajtur epror apo botë.

Nuk ka sesi të ndodhë ndryshe sepse bëhet fjalë për një marrëdhënie të ndërsjelltë ekzistence: Jemi bijtë e vendit tonë, e duam dhe na do, i japim dhe na jep, ia kemi nevojën dhe na e ka, por mbi të gjitha ne jemi sepse ai është dhe ai është sepse ne jemi. I jemi borxhli dhe tërë veprën tonë duhet ta vëmë në shkëmbim të këtij borxhi.

Nëse flasim për vepra dhe për stërmundime menjëherë na kujtohen faqe të tëra për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu. Sa herë e dëgjojmë emrin e tij, instinktivisht ne ngremë kokën lart dhe krenohemi me origjinën tonë. Ai akoma na jep forcë, na parashtroi mënyrën e duhur dhe na la rrugën e hapur drejt përparimit dhe progresit. Kam përshtypjen se të gjithë shqiptarët , në veçanti ne dibranët kemi detyrime morale ndaj kësaj figure madhore. Ne duhet të jemi aktiv në përcaktimin e fatit të Shqipërisë. Nëse ajo ndodhet në udhëkryq ne do t'i japim udhën e drejtë e do themi me zë të lartë "Shqipërisë i erdhi dita"

Nga disa burime, por edhe nga një trashëgimi vlerash dhe virtytesh vazhdoj të bindem se në venat e këtij heroi rridhte gjak dibrani. Edhe dikush që s'ka lindur për të qenë poet mund të shkruaj pafundësisht sepse ai është krenaria për paraardhësit tanë, është një frymëzim për punë dhe përpjekje.

Në qendër të qytetit të bukur të Peshkopisë, ngrihet madhështor monumenti i Gjergj Kastrioti Skënderbeut, dhuratë kjo e Zaim Korsit, një dibranë i mirë që ka dëshirë gjithmonë të bëjë punë të mira për vendlindjen .

Vetë Dibra , vendlindja ku qendra e vetme administrative është qyteti i Peshkopisë ndodhet vetëm 170 km nga kryeqyteti por është djepi i një morie vlerash, virtytesh, bëmash, heronjsh, mendjeve të mëdha, njerëzve frytdhënës e plot vitalitet. Ndoshta një vendi të tillë i shkojnë për shtat njerëz të ndershëm , dinjitoz e punëtor.

Tashmë me rrugën e Arbërit çdokush, edhe ata të cilët nuk i lidh gjaku dhe kujtimet mund dhe duhet ta vizitojnë këtë oaz vlerash. Jo vetëm për kulturën , por edhe për pasuritë e mëdha turistike ia vlen ta vizitojnë. Vetë Dibra me të gjitha fshatrat e saj, me qytetin e bukur të Peshkopisë përbën një pasuri në kuptimin e plotë të fjalës (me veshjet tradicionale, me folklorin aq të pasur, me gatimin, me relievin, me hidrografinë, me traditat, me zakonet, me kulturën dhe dijen që njerëzit mbajnë mbi supe). Ajo shtrihet në dy anët e lumit Drin. Në afërsi të Peshkopisë shtrin këmbët edhe mali më i lartë i Shqipërisë, mali i Korabit. Me siguri do të ndiheni si të shtëpisë sepse e tillë është Dibra dhe e tillë është Peshkopia. Një derë e hapur për këdo që do të jetë mik. Dhe tashmë me filialin e universitetit që është hapur jo vetëm një mik më shumë për Dibrën dhe dibranët por për këdo që pretendon të jetë dikush në jetë. Një popull gjenetikisht inteligjent nuk mund t'i mungonte institucioni i dijes. Historia e ka treguar se e meritojmë plotësisht këtë.

Për tërë këto të thëna dhe për shumë të pathëna Dibra do të ketë gjithmonë vlerësimin dhe mirënjohjen tonë.

VOJSAVA LEKA
Studente në fakultetin e mjekësisë së përgjithshme



AMBASADORI RYKER VIZITOI DIBRËN E MADHE

Dibra model i tolerancës ndëretnike dhe fetare



Filip Ryker, ambasadori i SHBA-ve në Shkup më 26 tetor vizitoi Dibrën. Pas takimit me Argëtim Fidën dhe përfaqësues të pushtetit vendor për gazetarët deklaroi se, "erdha këtu të njoftohem si punohet në nivel lokal, sepse Dibra është model shembullor i tolerancës dhe bashkëpunimit ndëretnik dhe ndërfetar. Argëtim Fida, theksoi se, "me ambasadorin biseduam për perspektivat e qytetit tonë, për problemet me të cilat ballafaqohet komuna jonë, problemet e infrastrukturës rrugore në hyrje të qytetit nga të gjitha anët. Shprehëm nevojën që nga shteti i Maqedonisë të planifikohen mjete për tu lidhur në Rrugën e Arbërit dhe mjete të nevojshme për tu riparuar sistemi i ujitjes, për zhvillimin e komunës, hapjen e vendeve të punës dhe ndërprerjen e migrimit etj. SHBA-të janë miq të ngushtë të Dibrës, sepse në SHBA jeton edhe një Dibër tjetër. S'ka familje dibrane që nuk ka ndonjë të afërm në SHBA. Dibra është binjakëzuar me Staten Island, tha Fida.

Me këtë rast ambasadori Ryker, i shoqëruar nga kryetari Argëtim Fida, vizitoi edhe Manastirin Shën Mbigur, ku shprehu keqardhjen e tij për këtë dëm të shkaktuar nga zjarri dhe informoi se të punësuarit në ambasadën e SHBA-ve kanë dhënë një ndihmë financiare, ndërsa ambasada do të shikojë mundësinë e ndihmës nëpërmjet projekteve përkatëse.

Gjatë qëndrimit të tij në Dibër ambasadori Ryker vizitoi edhe myftininë e Dibrës ku u prit nga Myftiu Mr.Ruzhdi Lata.

REXHEP TORTE

ARGËTIM FIDA ME DELEGACIONIN E MAQEDONISË NË FRANCË

Bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash mes komunave

Në vizitën disa ditëshe që Musa Xhaferi, ministër i Pushtetit Vendor e kreu në Normandinë e Poshtme në Francë,me ftesë të kryetarit të këtij rajoni z.Laurent Beauvais, ishte edhe Argëtim Fida kryetar i Komunës së Dibrës dhe kryetari i Komunës së Ohrit. Fida në takimin me gazetarë, tha se, " Me këtë rast u nënshkruajt Marrëveshja për bashkëpunim, hapje dhe reciprocitet ndërmjet Maqedonisë dhe rajonit Normandia e Poshtme, me ç'rast hapet mundësia e binjakëzimit të Dibrës, Ohrit dhe komunave të tjera të Maqedonisë me komunat si motra më të zhvilluara të Normandisë së Poshtme".

Gjatë qëndrimit tonë, shtoi Fida, "ne nënshkruam një Memorandum bashkëpunimi mes Komunës së Dibrës dhe Komunës IF-it që do të jetë hapi i parë që në të ardhmen Këshillat Komunalë të dy komunave tona në seancat e tyre të vendosin për procedurat e binjakëzimit. Ky dokument ka të bëjë në rritjen e raporteve të miqësisë midis Maqedonisë dhe Francës. Ky bashkëpunim i decentralizuar ka të bëjë edhe me politikën e jashtme që është pjesë e pushtetit qendror, sepse paraqet edhe decentralizim të politikës së jashtme të dy vendeve tona që ajo shtrihet edhe në nivel të komunave. Kjo do të mundësojë njohjen më të mirë të qytetarëve të Maqedonisë dhe qytetarëve të Francës në frymën e miqësimit, që faktorët relevantë në Dibër dhe IF në projektet e tyre në planë të parë ta vendosin interesin e përbashkët.

Ne u dhamë përparësi tre temave, që kanë të bëjnë me zhvillimin e partneritet institucional mbi bazën e kompetencave që na jep Ligji për vetëqeverisjen lokale, të ngremë vetëdijen te qytetarët e Komunës së Dibrës dhe IF-it, për Integrimin Evropian, për globalizimin që të kemi qasje për tu afruar drejt botës. Ne si kryetarë komunash duhet të ndjekim, stimulojmë e bashkërendojmë programet e bashkëpunimit nëpërmjet shoqatave joqeveritare, shoqatave të rinjve dhe institucioneve të komunës. Në kuadër të këtij bashkëpunimi të rinjtë e shkolluar do të kenë mundësinë të bëjnë një praktikë disa muajshe në Francë dhe anasjelltas, ku do të njoftohen me përvojat e ndërsjella, duke krijuar urat e miqësisë mes dy popujve. Me këtë rast u nënshkrua edhe Memorandumi mes Komunës së Ohrit dhe KAEN-it. Ne do të jemi si lokomotivë që do ta tërheq edhe interesin e komunave tjera në Maqedoni" tha në fund Fida.

Rexhep TORTE

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: "rrugaearberit@gmail.com". Tel. 00355 4 22 33 283.
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

intervistë

Hajri Hoxha: Ja si u mposhtët tërmetin e 30 nëntorit 1967, në atë dimër të ashpër, në ato kushte atmosferike të pa përjetuara ndonjëherë?

A MPOSHTEN **TËRMETET**?



Në foto: **Hajri Hoxha**

Hajri Hoxha! Më 30 nëntor të vitit 1967, në orën 8 e 17 minuta të mëngjesit Dibrën dhe Librazhdin e tundi një tërmet i fuqishëm, tërmet që mori jetë njerëzish, shkatërroi nga themelet shtëpi dhe objekte socialkulturore. Ju atëherë keni qenë kryetar i shtabit të rrethit të Dibrës për eliminimin e pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore. Më 6 shtator të këtij viti, po në Dibër, me epiqendër Gjoricën dhe Shupenzën, ra një tërmet pothuajse i të njëjtës shkallë. Ju keni botuar atëkohë edhe një libër "Edhe tërmetet mposhten" me përvojë të drejtpërdrejtë pune për eliminimin pasojave që rrodhën. Si e mposhtët tërmetin e 30 nëntorit 1967, në atë dimër të ashpër, në ato kushte atmosferike të pa përjetuara ndonjëherë?

Ajo ishte, për të gjithë popullin shqiptar, por veçanërisht për popullin e Dibrës, një fatkeqësi natyrore. Tërmeti ishte afro shtatë ballësh. Fat ishte se na gjeti jashtë...

Ishte mëngjes...

Po, në orën 8 e 17 minuta të mëngjesit. Një pjesë e madhe e njerëzve kishin dalë në punë. Nxënësit, pas pushimit të festave të Nëntorit, kishin shkuar në shkollë. Çasteve të para të hutimit që erdhi nga tronditja e madhe ia zu vendin gjakftohtësia, vendosmëria për tu qëndruar njerëzve pranë dhe për të kapërcyer çdo vështirësi.

Tërmeti kishte goditur rëndë Maqellarën, Shupenzën, Ostrenin, Klenjën, Bulqizën, fshatrat rreth Peshkopisë, Librazhdin. Katastrofa natyrore mori jetën e 12 vetëve dhe plagosjen e 129 vetëve. U dëmtuan 3536 shtëpi banimi ose 37 për qind e ndërtesave të 88 fshatrave të prekura nga tërmeti. Prej tyre 436 ishin shembur nga themelet. U dëmtuan 73 shkolla, 16 e të cilave u shembën plotësisht. U dëmtuan rëndë 6 spitale e shtëpi lindjeje, 34 dyqane, 22 magazina, 18 stalla, hangarë etj. Më e rëndë ishte gjendja në fshatrat Sebisht, Zabzun, Steblevë, Klenjë, Ostren i Madh, Ostren i Vogël, Lladomericë, Radovesh, Vojnikë, Çernenë, Kovashicë, Burim, Majtarë ku thuajse 70 për qind e shtëpive ose ishin dëmtuar rëndë ose ishin shembur fare...

Cilat ishin masat që morët?

Menjëherë u krijua shtabi. Unë në atë kohë isha kryetar i Komitetit Ekzekutiv të rrethit. Menjëherë, si në çdo fatkeqësi, shteti dhe shoqëria na u gjet në krah. Menjëherë erdhën drejtues të partisë e të shtetit por më parë se ata erdhi ajo që quhet solidaritet popullor, të qenit pranë në fatkeqësi, karakteristikë e popullit tonë. Menjëherë, krahas telegrameve të solidaritetit nga Vermoshi në Konispol, u krijuan brigada të posaçme. Brigada e parë erdhi nga Vlora. Erdhën 129 vetë, specialistë të fushave të ndryshme si muratorë, karpentierë, elektricistë, inxhinierë ndërtimi, mekanikë etj. Brenda 3-4 ditëve Dibra u mbush me brigada ndërtimi nga të katër anët e vendit, brigada nga Saranda, Gjirokastra, Konispoli, Durrësi, Tirana, Mati Kukësi... brigada që u vendosën në të gjitha qendrat e banuar, në çadra apo në shtëpi që i kishin qëndruar tërmetit.

Unë, asokohe kam qenë me nxënësit e shkollës së mesme bujqësore "Nazmi Rushiti" të Peshkopisë dhe kemi fjetur për ditë të tëra në dyshekë kashte shtruar përtokë në vatrën e kulturës të Çernenës në Maqellarë...

Ashtu është. Mbi të gjitha në dispozicion të punës për eliminimin e pasojave të tërmetit u vunë parqet automobilistike të vendit. Heroizmi i shoferëve të parkut të Laçit, Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Shkodrës, Vlorës, Korçës ishte i pa shoq. Ata udhëtuan në dëborë e në akull, rrugë pa rrugë dhe dërguan në çdo fshat, për të mos thënë në çdo shtëpi, materialet e ndërtimit; tulla, tjegulla, çimento, gëlqere, lëndë drusore, dyer, dritare, çdo gjë që duhej.



Pastërmeti 1967. Ndërtimi i shtëpive vazhdon edhe në borë...

Punë të madhe bëri edhe vetë populli i Dibrës. Që nga Lura, Selishta, Reçi e Dardha, Kalaja e Dodës, Sllova, Kastrioti, Muhurri, zona efektivisht të prekura lehtë ose të paprekura nga tërmeti erdhën brigada të posaçme ndërtuesish bashkë me të gjithë bazën materiale ndërtuese dhe u vendosën në zonat e Ostrenit, Klenjës, Steblevës, Okshtunit e deri në Llangë në kufi me Librazhdin ku edhe atje vazhdonte puna për eliminimin e pasojave të tërmetit.

E shkruar në historinë e kësaj lufte heroike është edhe brigada e kufitarëve të vendit tonë, brigadë e cila veproi në zonën e Lladomericës, atje ku ra në krye të detyrës kufitari Agron Elezi, detyrë të cilën erdhi dhe e mori i vëllai i tij Mehmeti.

Çfarë vështirësish teknike kaluat duke pasur parasysh se dhjetori i atij viti ishte dhjetori më i ftohtë që mbahet mend, me dëborë, me ngrica, me temperatura që shkonin deri në minus pesëmbëdhjetë gradë?

Siç e ke jetuar edhe vetë problem ishte lidhja e murit, vendosja e tullave. Llaçi, nga temperaturat e ulëta, ngrinte në vend. Këtu lulëzoi përvoja popullore. Gani Tuçepi, Hero i Punës Socialiste, njeriu që me nivelën e ujit me peplumç dhe me pushkë, me siguri ke dëgjuar për

Llaçi, nga temperaturat e ulëta, ngrinte në vend. Këtu lulëzoi përvoja popullore. Gani Tuçepi mblodhi dru, ndezi zjarre, shtroi mbi to llamarina e mbi ta gatoi llaç. Për ta bërë llaçin të qëndrueshëm ndaj ngricës ai përzjeu në të kripë të zezë, nga ajo kripa që përdorej për të eliminuar akullin në rrugë. Shumë shtëpi në Dibër, në ato ditë ngricash të mëdha kanë në mure kripën e asaj pune me të vërtetë jo vetëm heroike por edhe të një përvoje të madhe popullore.



Pastërmeti 2009. Nis shpërndarja e çadrave

piketimin e tij "me pushkë" të kanalit të Çidhnës, ky njeri i palodhur i kanaleve ujitëse të Dibrës dhe të mbarë Shqipërisë e gatoi llaçin me zjarr e me kripë. Mblodh dru, ndezi zjarre, shtroi mbi to llamarina e mbi ta gatoi llaç. Për ta bërë llaçin të qëndrueshëm ndaj ngricës ai përzjeu në të kripë të zezë, nga ajo kripa që përdorej për të eliminuar akullin në rrugë. Shumë shtëpi në Dibër, në ato ditë ngricash të mëdha kanë në mure kripën e asaj pune me të vërtetë jo vetëm heroike por edhe të një përvoje të madhe popullore.

Me sa mbaj mend në atë kohë është elektrifikuar Shupenza dhe disa ditë pas kësaj u shpall aksioni i madh kombëtar për elektrifikimin e gjithë Shqipërisë, elektrifikim që përfundoi më 25 tetor 1971...

Në Shupenzë na prunë dhuratë një motogjenerator. Me të kishte ardhur edhe një pedagog i fakultetit të inxhinierisë elektrike të Universitetit e Tiranës emrin e të cilit nuk po e kujtoj. U ndërtua një barakë, në të u vu gjeneratori dhe brenda 24 orëve u vunë shtyllat, u shtruan telat dhe drita elektrike hyri në çdo shtëpi në Shupenzë. Më tej linja elektrike u shtri edhe shtëpitë e para në Gjoricë dhe në Boçevë. Ky ishte sinjali i parë i punës së madhe që përfshiu të gjithë Shqipërinë për elektrifikimin e mbarë vendit.

Më 6 shtator në Dibër ra një tërmet i të njëjtës shkallë. Si e shikon Hajri Hoxha, nisur nga përvoja e tij, punën për eliminimin e pasojave të tërmetit të shtatorit 2009? Çfarë duhet të bënte shteti dhe shoqëria sot për të mposhtur pasojat e tërmetit?

Sa kemi parë në lajmet është e vërtetë se menjëherë shkuan drejtues të shtetit me Sali Berishën në krye por sa kemi parë më vonë, jo më larg se dje fshatarë të Shupenzës dhe të Gjoricës kërkonin që kryetari i qeverisë të mbajë fjalën e dhënë. Ata thoshin ne nuk duam lekë por duam bazë materiale, specialistë, të na i sjellin këtu dhe të na ndihmojnë për të hyrë në shtëpi para se të vijë dimri.

Mos ndoshta duhej një kthim në solidaritetin e kohës që përshkruat ju? Mos duheshin stimuluar bizneset e shumta të ndërtimit dhe të prodhimit të materialeve të ndërtimit për tu ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë?

Ajo do të ishte një nga masat kryesore, masë që siç e thashë në fillim, që në ditën e parë erdhi gatishmëria e popullit shqiptar dhe jo më larg se të nesërmen erdhi brigada e parë nga Vlora me 129 vetë e me bazë të plotë materiale. Një gjë të tillë nuk e pamë as ditën e parë dhe as pas një muaji.

Dhe me sa duket nuk do ta shohim...

Lëreni luginën e Drinit të Zi, të bukur siç e ka dhënë Zoti!

Replikë me Prof. dr. Pandi Stratoberda, Niko Pano e Alfred Frashëri, mbi shkrimin e botuar në gazetën Republika, date 4 tetor 2009, "Mbi sistemin hidrografik liqeni i Shkodrës-Bunë-Drin, perspektivat e zhvillimit dhe parregullsitë që ekzistojnë"

Nga: Murat KOLTRAKA

Vendi ynë, ende në tranzicion e në proces të shpejtë transformimi, ka nevojë më tepër se kurrë për fjalën e akademikëve, profesorëve, doktorëve, në të mirën e zhvillimit të vendit tonë. Ndonëse rrallë në shtyp shfaqet mendimi i tyre, ndonjëherë dhe na zhgënjejnë. Në gazetën 'Republika' të datës 04. 10. 2009 botohet një studim i tre Prof. dr. Pandi Stratoberda, Niko Pano e Alfred Frashëri mbi sistemin hidrografik liqeni i Shkodrës-Bunë-Drin, perspektivat e zhvillimit dhe parregullsitë që ekzistojnë. Shifrat dhe faktet e sjella prej tyre mbi shumëllojshmërinë e shpendëve, të amfibëve, të reptilëve, të molusqeve, gjitarëve e të tjera çështje, janë tregues të një punë serioze, që pasqyrojnë potencialin ekologjik të një ekosistemi, i cili, me të drejtë, duhet mbrojtur dhe për zhvillimin e mëtejshëm të tij duhen mënjanuar parregullsitë që pengojnë.

Duke marrë shkas nga shkrimi juaj, të nderuar zotërinj, deshëm të replikojmë pak me ju, jo për kompetencë shkencore e profesionalizëm, por se ju ne punën tuaj jeni treguar tepër të njëanshëm. Ju rekomandoni si të vetmen alternativë për mbrojtjen e ultësirës shkodrane e asaj malazeze, ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, pasi, sipas jush, variante të tjera janë të kushtueshëm.

Për rajonin që përmbytet, pasojat që i vijnë atij, ju nuk e keni vënë lapsin në letër, pra nuk u interesojnë. Kjo do të thotë, të shikosh vetëm njërën anë të medaljes, ose është si të bisedosh me vetveten. Trajtimi i një anshëm i këtij problemi, që përbën kërcënim për një komunitet, prej dhjetëra-mijëra banorësh, me tridhjetë fshatra të kësaj lugine, e të tjerët përreth, vë në diskutim qëllimin e studimit tuaj, motivet që u shtyjnë. E themi këtë pasi, ***ideja juaj është të asgjësohet një ekosistem, vlerat te tjera te mëdha te tij, për të mbrojtur një ekosistem tjetër;*** Ne ju pyesim: A mund të quhet zgjidhje, një justifikim si ai i juaji, që sakrifikon jo një, por disa zgjidhje të tjera duke sjellë katastrofë për një komunitet të tërë, pasoja të rënda për Dibrën ne tërësi? Ideja juaj të nderuar zotërinj nga ne dibranët lexohet: **"Qep një pëllëmbë e shqep një pash".**

Skavica përmbyt luginën e Drinit të Zi në një gjatësi prej 75 km, nga Kukësi në veri, deri në kufi me Maqedoninë në jug, asgjëson potenciale të mëdha etnike, ekonomike, kulturore, historike, ekologjike, te cilat ju nuk i keni studiuar, në një pellg të pasur mbi 160 km^{2,} që për këtë popull kanë një kosto shumë të madhe.

Dibra një etni, një gjak, një gjuhë, me të njëjtat tradita e zakone, me një histori të përbashkët, me 1913 u nda më dysh. Ata që e ndanë, nuk përfillën asnjë parim për vendosje, por vulosën vendimin duke marre me vete njollën e turpit gjate tere historisë. Dibra e Epërme padrejtësisht u kaloi sllavëve, Dibra e Poshtme i mbeti Shqipërisë. Kjo gjysmë e territoreve dibrane që i mbeti Shqipërisë, të nderuar zotërinj, ***a duhet të ndahet dhe një herë nga jugu në veri sipas idesë suaj?*** Nëse ndodh kështu, Dibra e Poshtme shpërbëhet.

Përmbytja e luginës së Drinit të Zi për mbrojtjen e "Aeroportit" më të madh të shpendëve e të gjallesave të tjera të një rajoni tjetër, për Dibrën në fushën ekonomike do të thotë; deri në 8000 ha tokë produktive më pak nga 12500 ha që ka Dibra gjithsej, deri me 8000 persona të larguar nga puna, pasi në një hektar tokë punësohet një punëtor, 200 mijë rrënjë dru frutorë më pak, 4000 hektarë foragjere, pa llogaritur pyjet, kullotat, material ndërtimi e të tjera.

Do të thotë 9000 krerë lopë nga racat më të mira, 25000 krerë të imta më pak, ndërsa në produktet, i hiqen nga menuja popullit të këtij rajoni; 9000 kv mish gjedhi cilësi e parë, 5000 kv mish të imtash, 32000 kv grurë, 70000 kv misër, 1.600.000 kv fruta, 180 000 kv qumësht lope, 21 000 kv qumësht të imtash në vit, perime të freskëta e të thata, e të tjera. Ky është vetëm hapi i parë i hedhur këto vitet e fundit nga qindra biznese të mesëm e të vegjël që ushtrojnë, aktivitetin në këtë rajon, kur mundësitë për të ardhmen janë shumë herë më të mëdha. Ndërtimi i Skavicës të nderuar zotërinj, ***zhduk nga harta e Shqipërisë një nga" Perlat "më të bukura e më të pasura në tërë territoret shqiptare***, produktet e saj në përmasa kolosale, konkurruese në tregun ndërkombëtar për cilësinë e lartë të tyre vite më parë, zhduk " Hambarin" e Dibrës e për rajonet përreth***, me ekzistencën e të cilit është e kushtëzuar jeta e popullit të këtij rajoni nga prehistoria deri në ditët tona.***

Pra ndërtimi i kësaj vepre për Dibrën do të thotë; më pak prodhime, më pak të ardhura, më pak dibranë në këtë rajon historik, më shumë ditë pa diell, më shumë ndotje të ambientit, më shumë rrezik për shëndetin e jetën e njerëzve e jo të shpendëve, amfibëve e të tjera gjall-



Foto: B. Karoshi

esave, që ju u kushtoheni në studimin tuaj. Ideja juaj të nderuar zotërinj, detyron mijëra banorë të lënë trojet e tyre etnike, pa qenë fajtor, ndërpret jetën njerëzore në këtë luginë pas më se 8000 vitesh jetë, të cilën nuk arritën ta ndërpresin luftërat në këtë rajon historikisht të trazuar, epidemite, as katastrofa të natyrës .

Ideja juaj mbi Skavicën fundos përgjithmonë vlera të pazëvendësueshme historike me rëndësi jo vetëm rajonale, por, sidomos kombëtare. Ne pellgun e Drinit të Zi, edhe pse ky rajon bën pjesë në një krahinë të brendshme malore, jeta ka filluar që në neolitin e hershëm, njëherësh me vendbanime të para në rajone të Adriatikut e të Mesdheut me një populli vazhdimisht të dendur dhe njeh vetëm vazhdimësi. ***Në këtë pellg, arkeologët, deri tani, kanë evidentuar 40 qendra arkeologjike, shumë prej tyre në nivele shumë të ulëta, që i përmbyt çdo variant i ndërtimit të kësaj vepre, vendbanime historike të virgjëra, që përfaqësojnë çdo epokë, në të cilën ka kaluar shoqëria njerëzore në më shumë se 8500 vite jetë.***

Zotërinj të nderuar: E tërë kjo pasuri e madhe historike, kulturore, shpirtërore, jo vetëm ekologjike e transmetuar nga brezi në brez ne mijëra vite, ***a duhet të fundoset përjetësisht nën ujë që mbi të rëndojë veç peshës së ujit edhe errësirës së përjetshme dhe pesha e harresës?***Çdo objekt arkeologjik ka jo vetëm vlera materiale, por sidomos vlera kulturore shpirtërore. Çdo gjeneratë i transmeton diçka vitale nga vetja, brezit pasardhës. Ç'do të thotë, të nderuar zotërinj, të fundosësh përjetësisht nën ujë një trashëgimi kaq të pasur të transmetuar në breza për mijëra vjet, ta fshish nga kujtesa e një populli dhe për brezat që do të vijnë për mbrojtjen e një ekosistemi tjetër?

Këto thesare janë vetëdija historike e një populli vital, janë të shenjta, për ta nuk ka çmim, ata as nuk mund te blihen, as te shiten për interesat e të tjerëve. Nuk mendojmë të ketë ndonjë vend ku intelektualët e vet t'u rekomandojmë pushtetarëve të atij shteti, të asgjësojnë thesare të tilla të historisë për të mbrojtur ekosistemin e një rajoni tjetër, gjallesat e tij, qoftë edhe për arsye më madhore.

Përfaqësojnë prehistorinë në Luginën e Drinit të Zi, vendbanimet e mëposhtme si: "Kronza" e Blliçes, "Burimi" në zonën e Maqellarës, që i përkasin neolitit të hershëm, ndërsa "Blliçja", "Çetushi" "Topojani", "Salbatra e Sule", "Topuzet", "Çuku i Lekës" "Zall – Sina", "Meja e Qytetit" ne Zall Dardhë e të tjera janë vendbanime prehistorike te mëvonshme.

Në këtë rajon përfaqësohet kultura qytetare ilire me tre qytete ilire, 1)në Zall – Dardhë, 2) ne Gjire të Përnezhës ne Fushë – Alie dhe 3) ne Gradec ne nivele shume të ulëta, qe çdo variant i Skavicës i përmbyt. Studiuesi latin Tit Livi shkruan (shek II p. e. s.) se në luginën e Drinit të Zi janë 14 qytete e kështjella ilire të penestëve (ende të palokalizuara). Më të përmendurat për luginën e Drinit te zi ne Dibër janë; "Uskana" qyteti i dyte pas Durrësit për nga madhësia në tërë trevat ilire, Draudaku, Oenea e famshme si qyteza më e fortifikuar të cilën prof. dokt. Kristo Frashëri, Apolon Baçe dhe studiuesit dibranë e lokalizojnë në fshatin Çidhën e Poshtme, pjesë e këtij rajoni.

Me territore të kësaj lugine janë të lidhur ekzistenca dhe historia e Kastriotëve. ***Këtu janë vendlindja dhe vendbanimi i Pal Kastriotit, i Gjonit, i heroit tonë kombëtar dhe hero i rilindjes evropiane, (sipas disa studiuesve), Gjergj Kastrioti Skënderbeu.*** Në këtë luginë buzë Drinit të Zi më 29 Qershor 1444 u zhvillua beteja e "Torviollit" e cila përfundoi me shpartallimin e plot te ushtrisë turke, jehona e të cilës u dëgjua në tërë kontinentin evropian, ngjalli shpresa shpëtimi për popujt në robëri, për të cilën Skënderbeu u vlerësua shumë dhe mori mesazhe urimi nga disa kancelari evropiane te kohës.

Me historinë e Kastriotëve lidhet vendi me toponimin "Kodra e Pareve". Disa studiues mendojnë se ka qenë tempull i Kastriotëve. Ka mendime se këtu mund të ketë lindur Skënderbeu. Këtë objekt e përmbyt dhe varianti më i ulët i ndërtimit të kësaj vepre. Në këtë pellg ndodhet Sina e Pal Kastriotit, fshat ku nis dalja e Kastriotëve në skenën e historisë, ndodhet Kastrioti, fshati i krijuar dhe i banuar nga Gjon Kastrioti. ***Këtu kaloi vitet e para të jetës heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.***

"Skavica" fundos varret e të parëve tanë, zhduk një toponomi mjaft të dendur me emra ilir, emra te tjerë te lidhur me emra fortesash, betejash, objektesh e pronash të Kastriotëve. "Viset e Çidhnës", janë vise të Skënderbeut, shkruan Barleti.

Fundoset "Ura e vjetër e Reçit, kryevepër arkitektonike në ndërtimin e urave, Katedralja e Shën Lleshit, (rrënojat) më e madhja në Ballkan me kapacitet mbi 2000 vende, ***ku zhvilloi punimet Kuvendi i dytë ndërkrahinore i Dukagjinit, më 1602.***

Fundoset "Ferra e Pashës" buzë Drinit të Zi që ka shërbyer si "Seli" e fisnikërisë së "Nëntë Maleve" historike të Dibrës për rreth pesë shekuj. Këtu janë marrë vendime historike sa herë ky rajon është kërcënuar, ose është sulmuar nga pushtues të huaj. Fundoset shtëpia e "Riza Lushës" ku më 1920 u krijua "Qeveria e Arrasit". Në këtë shtëpi u krijua shtabi që udhëhoqi kryengritjen dibrane për çlirimin e Dibrës nga pushtuesit serb.

Pa u zgjatur më tej të nderuar miq, ky rajon meriton të shpallet zonë muzeale e vlerave të mëdha historike. Në shërbim të idesë sonë mbi paprekshmërinë e këtyre burimeve të historisë, citojmë një pjesë nga gjeniu i jashtëzakonshëm Shekspir i cili shkruan: "**Nuk mund të pretendosh se e njeh një komb edhe sikur të jesh pjesë e tij, nëse nuk din historinë e prejardhjes së tij".** Për historinë e Dibrës volume të tëra nuk mjaftojnë, është me rëndësi kombëtare të nderuar zotërinj, si e tillë është dhe e juaja.

Në vendin e këtyre thesareve të historisë duhet investuar, jo për fundosjen e tyre në errësirë te përjetshme, por që të zbulohen, të dalin në dritë, që të mos heshtin, por të flasin dhe të presin vizitorë nga vendi e bota. Kush mohon historinë e një kombi ka mohuar ekzistencën e tij.

Dikur, për një ide të tillë, për luginën e Kolorados në Amerikë i nderuari presidenti amerikan i asaj kohe A. Linkoln këshillonte: "Lëreni luginën e Kolorados, të bukur ashtu siç e ka dhënë Zoti".

Studiuesit tanë nuk duhet të bëjnë studime të njëanshme, qe pushtetarët tanë të mos e njohin realitetin ashtu siç është.

Ju të nderuar zotërinj, kërkoni t'i shkulni themelet asaj përmendoreje madhështore, që Dibra ngriti gjatë tërë historisë, aq të lartë sa shikohet në Kosovë, në Shkodër, në Durrës, në Vlorë, në Janinë, kudo ku flitej gjuha e bukur e shqipes, pasi në këto vende prehen të qetë martirë dibranë, që dhanë jetën në mbështetje të bashkëkombësve të tyre sa herë kaluan stuhi të historisë në këto anë.

Lëreni luginën e Drinit të Zi, të bukur siç e ka dhënë Zoti, zotërinj të nderuar!

profil

"Është e këndshme për një vizitor nga Dibra në një qytet si Dallasi me gati 4 milion banorë, të dijë që diku në rrugën 75, gjendet një restorant Italian me pronar, dibranin e suksesshëm nga Kishaveci, Artur Pira."

Nga rreziku i burgut, në lirinë e suksesit

Nga: **AFRIM KAROSHI**

Disa muaj pasi fillova studimet në Dallas, një miku im më ftoi për një drekë në një restorant Italian por me pronar shqiptar. Miku im amerikan donte të më jepte kënaqësinë, jo vetëm për të ngrënë një vakt të mirë, por edhe të kisha mundësi të shkëmbeja ca fjalë në shqip. Rrugës për tek restoranti mora vesh që pronari ishte jo vetëm shqiptar por edhe dibran, nga fshati Kishavec i Dibrës, 15 km larg vendit ku jam rritur. Pasi përshëndetemi, mësoj më shumë për historinë e këtij dibrani, që na e solli rasti ta takoj mijëra kilometra larg vendlindjes.

"Në vitin 1989, unë isha në radhë për të hyrë në burg". Kështu e nis rrëfimin për jetën e tij, Artur Pira nga Kishaveci i Dibrës, në një bisedë miqësore në restorantin e tij në rrugën 75 në Richardson të Texasit, SHBA. Familja e Arturit kishte kaluar një kalvar të gjatë vrasjesh, burgosjesh dhe kërcënimi nën sistemin komunist. Familjarë të tij si Adem Pira, Dinja, Osmani, Milaimi u vranë, ose u dënuan me vite të tëra burgim. Vetëm disa patën fatin të lirohen nga fundi i viteve '80. Megjithëse edhe në këtë kohë kur ndihej një rreze shprese, Osmani vritet në Zimur në vitin 1986, vetëm disa vite përpara se komunizmi të humbiste pushtetin në Shqipëri.

Arturi kujton ndjesinë e qartë se pikërisht në këtë periudhë, kur një pjesë e mirë e paraardhësve në familjen e tij ose ishin vrarë ose ishin dënuar, i kishte ardhur rradha atij të ndjente presionin e pushtetit komunist. Megjithëse po kalonte një fazë të suksesshme në sportin e mundjes me skuadrën e Korabit, madje duke u shpallur kampion kombëtar në mundjen klasike, trysnia e persekutimit e nxit Arturin të fillojë të bëjë plane për tu larguar nga Shqipëria. "I fillova bisedat e para me një shokun tim që kishte qenë ushtar në kufi dhe bëmë planet për t'u larguar. Zgjodhëm pjesën e kufirit në drejtim të Maqedonisë, një pjesë e kufirit që nuk ishte shkelur prej 50 vjetësh", kujton Arturi. Pas orëve të tëra nëpër shkurre, me zvarritje dhe me vrap arritën anën tjetër të kufirit dhe u qetësuan kur panë drita në një zonë të banuar.

Hapi i parë drejt lirisë për Arturin nuk ishte aq i kënaqshëm. Arturi kujton një periudhë prej 11 muajsh nëpër burgjet e Beogradit, nën kërcënime dhe dhunë, bashkë më shumë shqiptarë, rusë dhe rumunë.

Kthesa e shumëpritur vjen kur Arturi transferohet në SHBA me ndërmjetësinë e kishës katolike amerikane. Prej aty, fillon shija e lirisë së kërkuar nga një regjim totalitar. Arturi punon mundimshëm derisa arrin të hapë biznesin e vet, një restorant Italian i quajtur "Aboca's". Pas kaq vitesh, Arturi ka ngritur jo vetëm një biznes fitimprurës, por gjithashtu një emër me shumë ndikim në një komunitet me miliona banorë në zonën e Dallasit. "Aboca's" është vlerësuar për cilësinë e ushqimit dhe të shërbimit, madje edhe ka fituar çmime në qytetin e Richardsonit për restorantin më të mirë Italian të vitit. Gjithashtu, herë pas herë, gazeta e Dallasit, "Dallas Morning News" ka vlerësuar kontributin e Artur Pirës për shërbimin që i ofron komunitetit, edhe sidomos njerëzve në nevojë. Arturi ofron ushqim falas për njerëz që nuk kanë mundësi të paguajnë, ofron dreka për organizata që ofrojnë ndihmë për njerëzit në nevojë. Në një intervistë për një gazetar të "Dallas Morning News", i pyetur për motivin se pse Arturi ndihmon njerëzit që janë në nevojë, Arturi u përgjigj: "Zoti më dha mundësinë që të vij në vendin më madhështor në botë për të filluar një jetë të re. Unë nuk dua ta kthej këtë mundësi mbrapsht. Nuk do ta kthej mbrapsht nevojtarin. Në të kundërt, unë do t'ju ofroj ushqim dhe respekt". Fraza "Ushqim dhe respekt" sikur buron nga kodi etik i dibranit, megjithëse i rritur në halle e vështirësi ekonomike, me mungesën e elementëve bazë të jetesës.



Restorant "Aboca's"

"Jeta në Dibër ka qenë e vështirë, por megjithëse kanë kaluar gati 20 vjet nga largimi, akoma ëndrrat i shikoj në Shqipëri". "I kam të gjitha të mirat," thotë Arturi duke treguar ambientin e restorantit, "por s'ka ditë që të mos flasim për Shqipërinë në restorant". Patjetër që të afërmit dhe kushërinjtë që ka në Tiranë dhe Dibër i mungojnë, por edhe për Drinin e merr malli. "Çfarë nuk do të bëja, për ta pasur këtë biznes dhe këtë lloj mundësie në Shqipëri".



Por liria e fituar kaq larg Shqipërisë, ka krijuar një tjetër lloj "robërie" që Arturi e ndan sapo të kesh filluar bisedën me të. "Jeta në Dibër ka qenë e vështirë, por megjithëse kanë kaluar gati 20 vjet nga largimi, akoma ëndrrat i shikoj në Shqipëri", thotë ai, duke sjellë në mend mallin që ka për vendin dhe familjen që ka lënë pas. "I kam të gjitha të mirat," thotë Arturi duke treguar ambientin e restorantit, "por s'ka ditë që të mos flasim për Shqipërinë në restorant". Patjetër që të afërmit dhe kushërinjtë që ka në Tiranë dhe Dibër i mungojnë, por edhe për Drinin e merr malli. "Çfarë nuk do të bëja", thekson Arturi, "për ta pasur këtë biznes dhe këtë lloj mundësie në Shqipëri".

Ai kthehet pothuajse çdo vit për të vizituar të afërmit dhe familjarët. Bën komente për situatën në Shqipëri, duke përzier në to mallin për vendin, dëshirën për lirinë akoma jo në standardet e ëndërruara dhe shpresën për një të ardhme më të mirë.

Arturi e përmbush dëshirën për të ndihmuar Shqipërinë edhe duke ofruar ndihmën e tij për pothuajse çdo shqiptar në nevojë që shkon në Dallas. Janë me dhjetëra historitë që tregojnë miqtë e tij, të punësuarit në restorantin e tij që e kanë provuar kujdesin dhe ndihmën e Arturit.

"Shpresoj që Shqipëria do të vazhdojë të zhvillohet edhe njerëzit të përjetojnë më shumë zhvillim dhe liri, sepse nuk do t'ia dëshiroja askujt të kthehej në situatën time, "në pritje të burgut" për një jetë më të mirë", e mbyll bisedën Arturi.

Është e këndshme për një vizitor nga Dibra në një qytet si Dallasi me gati 4 milion banorë, të dijë që diku në rrugën 75 gjendet një restorant Italian me pronar, dibranin e suksesshëm nga Kishaveci, Artur Pira.

Pajtohuni në gazetën "Rruga e Arbërit"

www.dibra.org

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

Pajtimi në gazetë kushton 600 lekë në vit
*dhe gazeta ju vjen me postë në shtëpinë tuaj**

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për të pritur letrat e lexuesve për problemet dhe shqetësimet e tyre.
Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.
Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.
* Për ata që duan që gazeta t'ju shkojë me postë në shtëpi, ju lutem konfirmoni në redaksi adresën e saktë

Rruga Arbërit nr. 42
specialisti

Rajonit i mungojnë ato tregje në të cilat të tregtohen vetëm prodhime bujqësore e blegtorale.



"Festa e të vjelave, 2008". Foto: Grehans Uka

"Rruga e Arbërit", tregjet bujqësore rajonale dhe panairet e agro-bisnesit

Nga: **DALI HORESHKA**

Dibra ka mjaft probleme, por përfundimi së ndërtuari i rrugës së Arbërit, do ti hapte asaj mjaft perspektiva, duke bërë midis të tjerash të ndjehet emergjent ndërtimi dhe funksionimi i tregjeve rajonale, duke qenë mjaft të qartë mbi ndarjen apo kombinimin midis shumicës dhe pakicës.

Ashtu si në shkrimin e një numri më parë, unë bëra thirrje për një tryezë debati mediatik mbi çështjet e bujqësisë, mendova se shembulli duhet dhënë nga vetja, duke trajtuar kësaj radhe një tjetër temë të së njëjtës rëndësi. Dibra ka mjaft probleme, por përfundimi së ndërtuari i rrugës së Arbërit, do ti hapte asaj mjaft perspektiva, duke bërë midis të tjerash të ndjehet emergjent ndërtimi dhe funksionimi i tregjeve rajonale, duke qenë mjaft të qartë mbi ndarjen apo kombinimin midis shumicës dhe pakicës.

KU MUNGOJNË KËTO TREGJE?

Dibrës i mungojnë ato tregje në të cilat të tregtohen vetëm prodhime bujqësore e blegtorale. Në Dibër, asnjë nga rajonet nuk ka treg të prodhimeve bujqësore, ndonëse kjo tregti bëhet, por në rrugë dhe pa kushte as për fshatarin dhe as për qeverisjen vendore, e cila mund të sigurojë mjaft të ardhura nga ato. Kjo mungesë fillon nga Peshkopia me tregun e pakicës (sepse ai i shumicës ka përfunduar pavarësisht se akoma nuk është në funksion), me Maqellarën, Shupenzën, Ostrenin, Bulqizën, Klosin dhe qytetin e Burrelit.

PËRVOJAT E HIDHURA

Përvojat e hidhura apo falimentimet me ndërtimin e tregjeve duhen studiuar para se ndërtimet të fillojnë. Ky dështim ka ardhur kryesisht për faktin se nuk është studiuar më parë nevoja për t'i ndërtuar ato dhe nuk është gjetur pozicioni i duhur në raport me konsumatorin, i cili duhet të jetë joshës për to, duke i patur mundësitë e lëvizjes me makinë dhe në këmbë si dhe mundësia e aksidenteve nga lëvizja e makinave të mos ekzistojë. Ky dështim as që ka vend për qendrat e mësipërme, pasi tregjet pa kushtet e nevojshme në këto zona kanë ekzistuar. Përvojat e deritanishme na ka treguar se nëpërmjet këtyre tregjeve është e mundur të shitet rreth 30% e prodhimit.

A MUND TË DËSHTOHET PËRSËRI DHE PSE?

Madhësia e tregut, menaxhimi dhe organizimi i brendshëm janë esencial. Madhësia e tregut llogaritet duke marrë në konsideratë nevojat për konsum dhe potencialin furnizues. Të dy këto tregues duhen konsideruar edhe në raport me tregjet ekzistuese dhe konkurueshmërinë ndaj tyre në shërbimin që ato sigurojnë, duke arritur në një sipërfaqe në m/2, por përfshirë këtu edhe parkimin, i cili po bëhet kërkesë e ditës. Përvojat dëshmojnë se ka një normë prej 0.3-05 m/2 për frymë.

PROJEKTET PER TREGJET

Është më se e vërtetë që shumica e komunave dhe bashkive në qarkun e Dibrës kanë hartuar planet e tyre strategjike të zhvillimit ekonomik dhe disa prej tyre kanë parashikuar ndërtim tregjesh, por ka shumë të ngjarë që shumë pak ose aspak nga



këto të kenë programet e ndërtimit të tregjeve. Akoma drejtuesit e komunave dhe bashkive kanë konceptin se mjafton të dish koston e një tregu dhe të kesh paratë dhe gjithçka merr fund pozitivisht. Do të thoja që hapja e një dialogu midis drejtuesve të komunave dhe bashkive me pjesëmarrje të MPV(B) dhe ministrisë së bujqësisë për të qartësuar format e ndërtimit dhe mënyrat e menaxhimit do të ishte me mjaft vlera. Shtrydhja e përvojave ekzistuese dhe krijimi i atyre të rejave duhet të përbëjë një objektiv të qeverisjes vendore dhe asaj të Ministrisë së Bujqësisë. Të paktën, komunat dhe bashkitë që unë përmenda më sipër, kanë në dorë të vjelin nëpërmjet tregjeve një të ardhur që varion nga 100-200 mijë lekë në javë dhe është e barabartë me 5-10 milion lekë në vit, për të mos thënë më shumë.

MENAXHIMI I TREGJEVE

Ato mund të menaxhohen nga bashkitë, por nëse formulohet një kompleks kushtesh reale kontraktuale, ato mund të menaxhohen mjaft mirë nga kompanitë private. Ndërtimi serioz i kushteve të kontratës, çmimit apo qerasë për m/2 përbën themelin e suksesit. Përvojat në këtë drejtim nuk është e vështirë të gjenden, analizohen, tu gjendet ajo që u duhet marrë e ajo që u duhet lënë, të përfshihen në zbatim dhe pastaj të konsolidohet përvoja e kthehet në tradite dhe jo në mjet që pasuron të preferuarit. Jo pak raste kemi dëgjuar që akoma pa bërë vitin një pasuri e blerë me paratë e taksapaguesve, veç kur merr vesh se është shitur dhe me një çmim qesharak. Dhënia e tregjeve me qira. Përvojë në këtë drejtim kanë Korça, Lushnja dhe Laçi.

KU TI GJEJMË PARATË?

Mjafton të jemi të bindur se programi ynë do të bindte këdo që tregu do të ishte i suksesshëm dhe unë besoj që paratë gjenden. Treguesi më i mirë që shpreh se aftësinë planifikuese dhe menaxhuese e kontrolluese të stafeve të qeverisjes vendore apo qoftë edhe të bizneseve është aftësi kredi-marrëse dhe burimet ekzistuese bashkëfinancuese. Këto tregje mund të përdoren nesër shumë mirë edhe për t'u dhënë me qera ndaj organizatave që kërkojnë të organizojnë panaire. Bashkitë dhe komunat mund t'i kthejnë këto tregje në ekspozita të prodhimit tradicional, duke kthyer në kapital prodhimin ekzistues, nxitur punësimin dhe rritur prodhimin. Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë është një tjetër mundësi / burim i sigurimit të parave.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL

Mjaft komuna apo bashki mund të kenë ndërthurje interesash në ndërtimin e tregjeve dhe kjo kërkon një bashkëpunim nga ana e tyre. Kur ky bashkëpunim i tyre është i qartë, bindës dhe i dokumentuar, mund të joshë shumë më tepër si qeverinë ashtu edhe donatorët në miratimin e projekteve apo programeve. Një bashkëpunim të tillë mund ta vendosin Komuna Maqellara me atë të Melanit për një pjesë të territorit që mund ta ketë tregun në Maqellarë, Shupenza me Gjoricën e me ndonjë komuna nga ato të zonës Çerenec e Tuçep, Bulqiza me Fushë Bulqizën, etj. Ky bashkëpunim është një fushë e hapur edhe për probleme që lidhen me plotësimin e nevojave administrative për juristë, përkthyes, nëpunës të gjendjes civile etj.

KOLATERALI I KOMUNAVE DHE BASHKIVE DHE REGJISTRIMI I PASURIVE.

Është mjaft e sigurtë që edhe bashkitë apo komunat kur marrin kredi, e drejte e cila u është siguruar me ligjin e qeverisjes vendore, kur ato fillojnë ta kërkojnë një gjë të tille u kërkohet të kenë të regjistruar pasuritë e tyre apo kolaterialin. Në këtë këndvështrim, ato duhet të kenë të sistemuara vendimet e organeve kompetente që e kanë konfirmuar një gjë të tillë.

BIZNESI NUK KËRKON PARA, POR KUSHTE LEHTËSUESE DHE PASTAJ I ZGJIDH VETE PROBLEMET

Përsëri jemi tek rruga e sigurimit të parave. Një mënyrë tjetër e sigurimit të burimeve financiare është biznesi. Qeverisja vendore mjafton që të sigurojë lejen e ndërtimit, garancinë e ruajtjes së destinacionit dhe drejtimit të realizimit të shërbimit, vendosjen e kushteve që prodhojnë shërbim dhe rregull për qytetarin dhe pastaj nëpërmjet procesit të konkurrimit apo tenderimit zgjidhet biznesi më i mirë për të drejtuar këtë lloj shërbimi. Në këtë mënyrë nuk duhen para, por proces planifikimi dhe vendim-marrje.

DITËT E TREGJEVE

Do të ishte mjaft tradicionale që nëse këto tregje do të kenë fatin të ndërtohen një ditë, ato të kenë ditët e veçanta, duke ri-kujtuar traditën. P.sh. Peshkopia mund të ketë ditën e diel, Maqellara të enjten, e kështu me radhë.

VITI 2010 KA FILLUAR

Dua të them që gjerat bëhen me plan në çdo drejtim e jo më tek shteti që është absolute. Nëse gjërat mendojmë se mund ti realizojmë në mënyrë të rastësishme, edhe paratë do të na i japin në mënyrë të rastësishme. Rastësia pjell risk dhe akuzë. Nxitja nga ana Seksioneve të Zhvillimit rajonal në Qark, apo edhe Njësia Trajnuese, e cila ka fituar një përvojë mjaft të mirë në këtë drejtim, duke bërë të mundur futjen e ndërtimit të tregjeve në rrugën e planifikimit për vitin 2010, do të ishte një fillim premtues.

PANAIRET BUJQËSORE DHE TREGJET SI GARANTUESE E VAZHDIMËSISË

Prej një periudhe prej katër vitesh, duke filluar nga viti 2006, nën drejtimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit të Qarkut të Dibrës, organizimi i panaireve të prodhimeve bujqësore po kthehet në traditë. Dua të shfrytëzoj rastin të vë në dukje vizionin mjaft progresiv të Drejtorit të Bujqësisë Maksim Hajrullaj, i cili bëri të mundur angazhimin e stafit në ndryshimin e konceptit të mënyrës së organizimit dhe shumë elementeve përbërës.

Megjithatë, organizimi i këtyre panaireve ka nxjerrë në pah një kompleks problemesh. Synimi për t'ua kaluar këtë përgjegjësi organizatave të fermerëve në një periudhe prej 2-3 vitesh dhe një koordinimin i punës qysh në fillim të vitit me pushtetin vendor, si dhe futja në plan e këtij aktiviteti qysh në fillim të vitit, përbëjnë momentet themelore. Kalimi i pjesëmarrjes në mënyrë të lirë dhe me pagese për m/2, duke garantuar një shërbim dhe njoftim mjaft korrekt të konsumatorëve dhe blerësve është e ardhmja e këtij procesi.

Brenda 2-3 vitesh funksionimi i organizatave të fermerëve në rajon do ta bëjë më të lehtë transferimin e kësaj përgjegjësie.

Bashkëpunimi midis organizatave të fermerëve, Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pushtetit Vendor është domosdoshmëri, Sipërmarrja për të realizuar një gjë të tillë mund të kthehet mjaft mirë në mundësi financiare për organizata që e ndjejnë veten të aftë se mund ta realizojnë vërtet.

Tetor 2009.

profil



Duka, lojari me numrin 10 shënoi një "super gol" në Kupën e Botës për SHBA-në

Dilaver "Dilli" Duka, ylli i SHBA në Kupën e Botës

Nga: **BEQIR SINA**, New York

Kur skuadra e përfaqësues së fut bollit e Shteteve të Bashkuara, për moshat deri në 20 vjeç, trajneri i saj Tomas Rongen njoftoi 26 lojtarët që do të i "ngisnin trenit", mbasi fituan kualifikimin e grupit të Kampionatit Concacaf, dyshe si kualifikuese për në Kupën e Botës 2009, U-20 , një konsensus rreth tifozëve të futbollit amerikan, u tha se ishte me mjaft pyetje dhe shumë unanim. Kush është Dilaver "Dilli" Duka? A është ky edhe një emër i vërtetë, të përfaqësojë futbollin në ngritje të SHBA-ës në arenën ndërkombëtare? Aq më shumë pyetjet bëheshin edhe me të shumta kur mësohej se tre kushërinjtë e tij ishin dënuar nga një gjykatë në SHBA për terrorizëm.

Është e kuptueshme se pasuesit e ekipit kombëtar amerikan, ekspertët e specialistë që merren me talentet e futbollit në SHBA, përzgjedhësit e kombëtares në futboll, tifozët amerikan, rinia amerikane, thuhet se pothuajse nuk kishte dëgjuar fare për skuadrën universitare Rutgers, e Nju Xhersit, ku luan një futbollist 19 vjeçar, i talentuar, fenomen i futbollit, i cili quhet Dilaver "Dilli" Duka.

Në fund të fundit, çdo hamendje, pyetje dhe përgjigje, e merr kur të sheh vetë me sytë e tu, në "qilimin e blertë" duke luajtur në Kupën e Botës, në Trinidad dhe Tobago , në grupin C, ku bëjnë pjesë edhe Gjermania, Koreja e Jugut dhe Kameruni, edhe futbollistin e "Tri ngjyrave" të flamurit Amerikan, futbollistin numër 10 –të, Dilaver "Dilli" Duka. Futbollistin e përfaqësues Amerikane, që në ndeshjen kundra Kamerunit, jo vetëm që dha dy pasime të shkëlqyera dhe SHBA shënoi 4 herë, por Duka shënoi një "Super gol" nga rreth 30 metra diagonal.

Duka, e bëri regjistrimin për Kupën e Botës, një javë më parë se të fillonte kampionati botëror. Ai u thirr me përfaqësuesen e SHBA, kur selektori i tyre, kishte mbledhur skuadrën në Xhamajka dhe po përgatiej për ndeshjen e tyre të parë, në Kupën e Botës 2009, e cila u zhvillua në Trinidad dhe Tobago. Duka ishte për herë të parë, i veshur me fanellën të "Stars and Stripes" - "Yje dhe Rriga", fanelë që mbron ngjyrat e flamurit të SHBA-ës.

Në fakt, edhe ai si i ri ishte i tronditur për të marrë një ftesë të tillë, për t'u bërë pjesëtar i ekipit të SHBA - U20. "Unë isha shumë i habitur", tha ai në një email në portalin e komenteve sportive www.Goal.com. "Mendova se në qoftë se një lojtar nuk ishte në sistemin e të rinjve të ekipit kombëtar të SHBA, ata nuk do ta marrin për në përfaqësuesen e SHBA-ës, pra unë nuk mundet të merrja një telefonatë që të thirrem në ekipin e moshave nën 20 vjeç."

Për mesfushorin shqiptar, që mbron ngjyrat e SHBA-së, i cilësuar se është i shpejtë si rrufe, kjo është një "kthim prapa", për të kujtuar edhe futbollin në vendin e tij, Shqipërinë, kujtuar disa nga yjet e futbollit shqiptar, në të kaluarën dhe tani, dhe disa nga mundësitë më të shquara, t'i vënë ne jetë këtu në SHBA-së, me anë të futbollit.

Duka është një mesfushor i shpejtë. shtatëlartë, 1 meter dhe 79 cm i gjatë. Ai u bë i njohur në vitin e tij të parë me skuadrën e Universitetit e Rutgers "Scarlet Knights" kur ishte titullar në 18 nga 19 ndeshjet e sezonit dhe shënoi dy gola dhe dha 4 asiste.

19-vjeçari ka treguar një aftësi të shkëlqyer në kontrollin e lojës, dhe menaxhimin e saj në mesfushë, çka ka bërë që seleksionuesit e skuadrës amerikane t'a vendosin Dukën në qendër të vëmendjes. 1 metër e 79 centimetër i gjatë, ai gjatë sezonit të tij të parë në finale me Piscataway, ishte padyshim në lojë-fituesi në një lojë tepër të barabartë në finale (back-to-back në ndeshje). Ai shënoi dy herë që të fitojë Rutgers "kundër Piscataway të Santa Barbara.

Trajneri i ekipit përfaqësues të SHBA-ës, për moshat nën 20 vjeç, Rongen, thotë se "Duka, është një djalë i ri, i cili mund të luajë një rol kyç në skuadër".

"Ka një të vërtetë më shumë që mundet ai të kontribuojnë në këtë ekip, qoftë më shumë se një Taylor Toni, nga Universiteti i Jacksonville, ai është Dilli Duka, nga



KUSH ËSHTË FUTBOLLISTI DILAVER DUKA?

Pozicioni: **Mesfushor**
Datëlindja: **09/15/1989**
Vendlindja: **Montville, NJ, SH.B.A.**
Gjatësia: **1.79 m**
Skuadra: **Përfaqësuesja e SHBA Under - 20**

Rutgers, i cili duke u bashkuar me treshen Jeffrey, Bryen, Danny, janë domosdoshmërish emrat e "familjes futbollistike amerikane" që mund të luajnë një rol të rëndësishëm për SHBA-ës, në ndeshjet kualifikuese," tha trajneri i SHBA-ës, Rongen, në www. Goal.com.

Jeta, tani si futbollist i njohur, mund të bëhet edhe pak më e komplikuar, shumë shpejt, veçanërisht në qoftë se dikush kur të sheh në Kupën e Botës, që luan mirë, ka një performancë solide për në të ardhshmen. Kohët e fundit, Duka, ka "thashesheme," se ka tërhequr interes nga klubet e gjithë bota. Thashethemet vazhdojnë të qarkullojnë në forumet sportive, ku fansat, thonë se ai ka pasë kërkesa nga pala e Anderlehtit të Belgjikës, të cilët janë të interesuar, për fenomenin e Rutgers. Mirëpo, ka shkruajtur www. Goal.com, se ai nuk kishte "dëgjuar asgjë për këtë." Megjithatë, ai do të donte të luajnë futboll në Evropë në disa vende, ku për "zemër" thuhet se ka Shqipërinë.

"Qëllimi im final është që unë të bëhem një lojtar profesionist futbolli, dhe shpresojmë se një ditë kjo të ndodhë," shkruante Duka. "Unë jam shumë i lumtur në Rutgers dhe nuk kanë menduar për largim, por në të ardhmen e afërt që e di se çfarë mund të ndodhë do të luaja kudo."

Do ta kisha nder të luaja për Shqipërinë

Trajneri i kombëtares amerikane U-20, Thomas Rongen, e ka thirrur, vetë shqiptarin, me origjinë nga Dibra e Madhe, Dilaver Duka, në skuadrën e SHBA-ës, në moshën 20 vjeç, për ndeshjet e kampionatit të Kupës së Botës.


Një faqe interneti i fansave shqiptar, shkruante se Duka "Dilli", shquhet për teknikën e tij të lartë. Ai i përdor të dyja këmbët dhe është krijues i jashtëzakonshëm në fushë, pa harruar aftësinë dhe abilitetin e tij për të shënuar", shpjegon ish trajneri i Dukës dhe ish futbollisti i njohur i Partizanit dhe kombëtares Shqiptare, mbrojtësi Skënder Gega.

Personalisht, "Dilly", Duka, ka shprehur shumë interes që të luajë për skuadrën përfaqësuese të moshave, sepse e ndjen në gjak dashurinë e kombit të tij nga puna edukuese familjare që ka bërë babai i tij, i cili rregullisht i flet për Shqipërinë. "Jam rritur që i vogël me ndjenjën e shqiptarit. E ndjej në vetvete sikur jam rritur aty, ndonëse kam lindur këtu (SHBA). Unë do ta kem shumë kënaqësi dhe do të jetë një nder nëse me krijohet mundësia për të luajtur me Shqipërinë, aq më tepër që gjithçka mund të lehtësohet, pasi shumë shpejt unë mendoj të transferohem në Evropë, ku aktualisht kam 2-3 testime të programuara për t'u parë dhe vërejtur nga drejtues të klubeve te huaja gjatë periudhës Dhjetor-Janar-Shkurt " ka shpjeguar Dilaver Duka, posaçërisht për portalin e fansave sportiv shqiptar. www. Albaniasoccer. com, duke ëndërruar që një ditë të veshi fanellën Kuq e Zi.



Market KEN

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394



Rruga Arbërit nr. 42

portret

Bajram Mata qe një piktor gjenial, që e pati jetën të shkurtër dhe të mbushur me plot peripeci

Homazh për Bajram Matën

Nga: **XHAFER MARTINI**

> Shteti nuk bëri asgjë për Bajram Matën. Të paktën të bënte një inventar të hollësishëm të veprave me përbërjen e një komisioni dhe t'i ruante në kushte optimale veprat e tij. Për Bajram Matën mund të bëhej edhe një muze i veçantë.



"Te kroi" - Bajram Mata

(Vijon nga numri i kaluar)
Një herë, më kujtohet mirë, shkuam për të parë një vepër të Bajram Matës për një ekspozitë që do të hapej mbas disa muajsh. Temën e kishte zgjedhur të përshtatshme: një brigadë partizane që marshonte përmes dëborës në një pyll. Ajo vepër ishte një mrekulli, ose, më saktë të thuash, kishte nisur si një mrekulli, se Bajrami shpesh i linte punët të papërfunduara. E them pa tepruar dhe pa dashur të krijoj efekte që, kur shikoje atë vepër, ndjeje mornica në trup, të dukej se ishe vetë në atë dimër të egër në një pyll të madh me dëborë. Dëbora nuk ishte e bardhë, por si e kaltër. Kjo u ra në sy "specialistëve" dhe ia bënë vërejtje. Bajrami tha se ai ashtu e kishte parë, si të kaltër. Por ajo nuk ishte as e kaltër, as blu, nuk ishte njëngjyrëshe: Bajrami, me gjenialitetin që e karakterizonte, e kishte *çarë* qiellin dimëror dhe një purri i kaltër drite buronte që poshtë reve dhe binte mbi malin, ku udhëtonin partizanët. Gjurmët në dëborë nuk ishin anemike, por kishin brenda rraskapitjen e marshimit të gjatë, kishin lodhje kapitëse. Krijoje bindjen që secila prej tyre ishte bërë me mundim. Por ata që donin ta *ndihmonin* Bajramin vinin nga turma, nuk ishin pjesë e elitës mendore me të cilën mund të komunikonte Bajrami. Njerëzit që vijnë nga turma japin e marrin me njeri-tjetrin si enët komunikuese. Baza e tyre është reciprociteti, se ruhet niveli i ulët, sado të flasësh e të diskutosh. Niçe thotë se

"Reciprociteti është vulgaritet i madh: pikërisht bindja që ajo që bëj unë, nuk mund ta bëjë një tjetër, që nuk mund të ketë ekuivalencë, që, në një kuptim më të thellë, nuk mund të bëhet më, sepse është diçka që vetëm një herë është dhe një herë bëhet, përmban shkakun e izolimit aristokratik nga turma , sepse turma beson në "barazinë" dhe, si përdëllim, në reciprocitetin."

Një tjetër pikturë e Bajram Matës që më kujtohet mirë, ishte ajo e një vajze malësore, të veshur me rrobat karakteristike të krahinës që po mbushte ujë në krua. Nuk mund t'i afroheshe veprës se kujtoje se do të lageshe nga stërkalat e ujit. Kjo ndjehej, përjetohej. Ndjehej dhe freskia e pyllit ku ishte kroi, freskia e ujit, aromat dhe ngjyrat e jetës. Ndihej dhe kapej shëndeti i vashës, hareja e saj e brendshme, ajo bukuri moshe që e bën çdo vajzë të admirueshme.

Bajram Mata ishte mjeshtër i përpunimit të ngjyrave, ato nuk dukej se ishin vënë në telajo me furçën e piktorit. Krijoje idenë se buronin nga poshtë e nga lart, nga të gjitha anët. Por plotëshmërinë nuk ta krijonin imtësitë, se Bajrami nuk merrej me to, por ajo fryma e brendshme, ajo dritë hyjnore që përshkonte çdo vepër të tij. Duke parë atë pikturë në një ditë të nxehtë gushti, u çlodhëm dhe u flladitëm, u freskuam sikur të ishim vërtet pranë një burimi të tillë.

Një herë Bajrami, disa muaj para vdekjes, ngriti telajon para shtëpisë së kulturës "Haki Stërmilli " në Peshkopi, dhe po pikturonte peizazhin: një pjesë e lulishtes mbushur me drurë jofrutorë. Atë ditë Bajram Mata kishte dalë, si të thuash, të përshëndetej me bashkëqytetarët, me shokët dhe miqtë, me artin. I kishte rënë një nur i bukur dhe një ndriçim i tjetërsojshëm ishte në ata sytë e ndritshëm, në atë ballin e larë me dritë hyjnore. Kishte tamam portret artisti, pa asnjë njollë në shpirt. Them se Bajrami kishte dalë të punonte dhe të përshëndetej, sepse punonte me nxitim, në mënyrë të sigurtë, me një hov dhe dalldi shpirtërore që, po ta kishte pasur gjithë jetën, do të bënte mrekullira. Do të bëhej një Rembrand ose Pikaso. Po ne jemi njerëz të zakonshëm dhe nuk i shikojmë shenjat, paralajmërimet, nuk dimë t`i lexojmë profecitë. Kështu kumtesh, si Bajrami atë ditë, krijuesit gjenialë lënë shumë herë në momente tragjike të jetës së tyre, por që nuk kuptohen nga bashkëkohësit. Në plan të parë të tablosë së tij Bajrami kishte vënë një mështeknë. Njerëzit nuk e kuptonin çfarë po bënte. Nuk kishte mështeknë para tyre, kurse në tablo ishte. Madje e morën për të dehur edhe atë ditë, pasi Bajrami manifestonte një gjallëri të jashtëzakonshme. Po, Bajrami ishte i dehur, por jo nga pija, nga arti i vetë, ashtu si i ndodh çdo artisti të vërtetë."Pa njëfarë eksitimi …nuk mund të imagjinohet një Rafael,- thotë Niçe.-Të bësh muzikë është pak a shumë si të bësh fëmijë… tek artistët fekondimi pushon në të njëjtën kohë më aftësinë për krijim…Artistët nuk duhet të shikojnë asgjë ashtu si është, por duhet ta shikojnë çdo gjë në mënyrë të plotë, më të thjeshtë, më të fortë; për këtë është e nevojshme që ata të kenë në jetë një rini dhe një pranverë, një lloj dehjeje të zakonshme." Vërtet para syve të Bajramit nuk kishte mështeknë. Ai e kishte *marrë* atë në kodrën lart dhe e kishte vënë në plan të parë. Mështeknat i pëlqenin shumë dhe ajo mbante, si të thuash, peizazhin. Bajrami nuk e kopjonte natyrën, por e seleksiononte, bënte objekt të artit të tij atë që e përfaqësonte më mirë llojin vetë. Mështekna ishte shumë e bukur, në të sikur fshihej shpirti i Bajramit. Punoi rreth katër orë, derisa u lodh, derisa energjitë e tij shpirtërore dhe hyjnore u mbaruan. Tha që do ta vazhdonte nesër. Por të nesërmen ai nuk doli të pikturojë, as të pasnesërmen dhe asnjë ditë tjetër. Kishte qenë tabloja e fundit, që mbeti e papërfunduar si shumë të tjera. Bajrami nuk kishte më forca të mbahej, të luftonte. Atij i ishte mbaruar durimi dhe e la veten të rrëshqiste, të rrëzohej. "Njeriu nuk duhet ta lëshojë veten të rrëzohet me shpresë se dikush tjetër duhet ta ngrejë", thotë Makiaveli tek "Princi". Por Bajrami nuk ishte makiavelist.

Mbeti i vetëm. Askush nuk iu afrua. Të gjithë i shmangeshin. Kujtonin se po i njolloste më i panjollosuri, kujtonin se po u ulte dinjitetin më i dinjitetshmi. I kemi bërë të gjitha përpjekjet, thonin ata që duhej të bënin gjithçka për të. Po ç'kishin bërë ata? Ç'kishim bërë ne, të gjithë? Në fund të fundit tashmë mendoj se nuk mund të bëhej asgjë në atë rend dhe në atë shoqëri. Të veçantët, ata që dalin jashtë moralit të kohës, mendimtarët, nuk i do njeri, sepse "Filozofët nuk janë bërë që t'i duan. Shqiponjat nuk fluturojnë kurrë në grup", shprehet Niçe.

* * *

Krijuesit, shokët dhe miqtë, por edhe *partia mëmë*, u *përpoqën* për ta shpëtuar Bajram Matën, domethënë përdorën disa forma ndërhyrjeje dhe presioni që ai ta linte pijen dhe t'i futej punës. Këto përpjekje konsistonin në thirrje dhe këshillim në komitetin e partisë, në mbledhje artistësh dhe krijuesish, por edhe në ndërhyrje shokësh dhe miqsh. Shkurt, të gjithë i lanë duart si Pons Pilati, që dënoi Jezusin. Bajrami, nëse më lejohet të përdor një metaforë të guximshme, ishte një lloj Mesie. Zoti, herë pas here, dërgon ca misionarë, ca profetë të një lloji tjetër, por ne nuk i kuptojmë dhe nuk i duam. Ai ishte dërguar për ta shpëtuar shoqërinë dhe jo shoqëria atë. Ishte e kundërta ajo që duhej bërë. Por Bajrami nuk e kishte atë mundësi ta ndryshonte shoqërinë. Ai u vetësakrifikua dhe në këtë fushëpamje ai është heroi më modern. Si mund t'i dojë dhe t'i kuptojë profetët një shoqëri laike? Si mund të bëjë punë të mira një shoqëri që nuk beson në Zotin? Dostojevski thotë që "Atje ku nuk ka Zot, gjithçka është e lejuar." Nga lartësia e viteve dhe e përvojave të reja kuptohet që qasja e shoqërisë ndaj tij ishte mediokre, madje e turpshme. E shikonin piktorin e madh si një qenie eksperimentale, si një kavie, pa bërë përpjekje për t'ia njohur botën e thellë shpirtërore. Njerëzve sikur nuk u vinte keq për Bajramin që po degradohej dhe shkatërrohej, por për rregullat, moralin dhe mënyrën e jetesës së kohës. Në gjithë afrinë dhe ndërhyrjen kishte një pozë prej atij që të ngre për mëshirë, kishte një paternalizëm idiot që fyente edhe natyrën më të pandjeshme. Izajan Berlin thotë se "Askush nuk mund të më detyrojë të jem i lumtur sipas mënyrës së tij. Despotizmi më i keq është paternalizmi." Veprimeve për të shpëtuar Bajramin u mungonte humanizmi. Ato nuk kryheshin në emër të dashurisë për njeriun, por për të mbrojtur rregullin, disiplinën, moralin socialist që ndiheshin të kërcënuar. Veprimet për të shpëtuar Bajramin, në thelb, ishin antihumane, se nuk mund të ketë humanizëm ateist. Shoqëria shqiptare e asaj kohe ishte njëdimensionale: ajo kishte vetëm gjatësinë. Dy përmasat e tjera: gjerësinë dhe lartësinë nuk i kishte. Nuk ka qenie dhe objekt në botë që nuk i ka të tri dimensionet. Më qartë për dimensionet e jetës flet Martin Luter King-u: "Gjatësia e jetës është shtytja e brendshme për të realizuar qëllimet dhe ambiciet personale…Gjerësia e jetës është interesi drejtuar jashtë, drejtuar mirëqenies së të tjerëve. Lartësia e jetës është tensioni drejt lartësisë, drejt Perëndisë."

Bajram Mata mbeti i pavlerësuar më atë kohë. Ata që nuk kishin vlera si njerëz nuk mund të shikonin vlera tek Bajrami. E thamë një herë dhe po e përsëritim prapë, se Bajrami nuk ishte gur ndërtimi, por diamant. Por edhe diamanti ka vlerë në kushte të caktuara. "…me vlerën e njerëzve (ndodh) si me atë të diamantëve, që, për një farë mase të madhësisë, pastërtisë, përsosmërisë, kanë një çmim të caktuar dhe të treguar, por përtej kësaj mase mbetën pa çmim dhe nuk gjejnë blerës."

* * *

Erdhi një ditë që Bajramin e la edhe fuqia fizike. Po shkatërrohej nga ana shëndetësore. Pothuaj i braktisur jetoi kështu edhe një vit, derisa më në fund, dha frymën e fundit. Mohim pas mohimi, Bajrami arriti në përfundimin që ajo jetë nuk kishte kuptim të jetohej.

Dhe ne, mësuesit e dy shkollave tetëvjeçare "Demir Gashi" dhe "Irfan Hajrullai" shkuam për ta varrosur në Kukës, ku kishte pjesën më të madhe të familjes. Atë e mbuloi harresa. Por edhe gjatë këtyre viteve të sistemit demokratik askush nuk është kujtuar për Bajram Matën. Shoqëria e sotme hesht për të. Me përjashtim të atyre që e kanë njohur, askush nuk e kujton më. Shopenhauer thotë: "Dhe është për t`u çuditur sesa më i vlefshëm që të jetë njeriu për pasardhësit e tij e për njerëzimin mbarë, aq më tepër nuk ka për t`u njohur dhe çmuar prej njerëzve të kohës së vet." Por unë e di se kjo është e përkohshme, e di që ai do të kthehet prapë midis nesh dhe do ta marrë atë shkëlqim që meriton.

* * *

Bajrami u nda prej nesh, por ai na ka lënë veprën e madhe dhe të papërsëritshme. Vërtet nuk punoi shumë dhe mjaft vepra nuk i përfundoi, megjithatë ai la shumë, sepse këtu duhen futur edhe skicat, edhe vizatimet më të thjeshta, ato qindra faqe plot me etyde, që të linin mbresë kur i shikoje. Peshkopia megjithëse një qytet i vogël dhe i pazhvilluar në atë kohë kishte Galeri Arti dhe një sallë moderne ekspozitash. Të dyja këto kushtuan miliona lekë të asaj kohe, të dyja ishin në katet e para të pallateve shtetërore përballë njëra-tjetrës. Për çudi, Galerisë së Arteve dhe Sallës së Ekspozitave, u dolën pronarët, që i kthyen në klube dhe magazina. Po si mund t'u dilnin pronarët vetëm kateve të para? Pse nuk ndodhi kjo me ndonjë pallat tjetër? Sot nuk dihet ku kanë shkuar gjitha ato vepra në pikturë, disa prej të cilave ishin shumë të mira. Nuk dihet ku kanë shkuar edhe veprat e Bajram Matës. Kur vdiq Bajram Mata, dy objektet e mësipërme nuk ishin ndërtuar. Gjoja për t'i ruajtur, veprat e Bajramit i futën kapicë në një qilar me lagështi ku nuk hynte asnjë rreze drite. Unë i kam parë aty dhe më ka ardhur shumë keq. Sot nuk dihet se ku janë. Shteti as këtë nuk e bëri: të bënte një inventar të hollësishëm në përbërjen e një komisioni dhe t'i ruante në kushte optimale veprat e tij. Për Bajram Matën mund të bëhej edhe një muze i veçantë. E meritonte. Dhëntë Zoti që brezat e ardhshëm të mos jenë të pandjeshëm ndaj njerëzve të ndritur të kombit tonë. Bajram Mata kishte si aspiratë dhe tipar të karakterit të tij ndryshimin; ai ishte një hero modern. Por ne heronjtë i konceptojmë vetëm si të pushkës dhe jo të penës dhe të penelit. Jemi ende tek koncepti tradicionalist për heroin. Në Peshkopi, në një copë, vend ka gjashtë buste, të gjithë janë heronj të pushkës, duke filluar nga Skënderbeu.

Por ka edhe heronj të kulturës, të penës, daltës, penelit. Midis këtyre vendin e parë do ta zinte Bajram Mata.

(FUND)

arsim

"Për t'i ardhur në ndihmë prodhimit të kromit, plotësimit të nevojave për kuadro (teknik e zjarrmëtar) u hap në Bulqizë 40 vjet ma parë shkolla e mesme e minierave"

Misioni i lënë përgjysmë



Shkolla Bulqizë në Festivalin e Lojërave Popullore. Peshkopi, 1975

Nga: **ZABIT LLESHI**,
ish zv drejtor i shkollës së minierave Bulqizë.

Vitet 60-70 të shekullit të kaluar arsimi 8 vjeçar ishte shtrirë në qytet dhe në fshatrat e Bulqizës. Ishin pjekur kushtet për zgjerimin e arsimit të mesëm e kryesisht të atij profesional. Për t'i ardhur në ndihmë prodhimit të kromit, plotësimit të nevojave për kuadro(teknik e zjarrmëtar) u hap në Bulqizë 40 vjet ma parë shkolla e mesme e minierave. Vështirësitë e para si mungesa e kuadrit, konvikti u kaluan me sukses në saj të punës e pasionit të një kolektivi mësuesish të rinj nën drejtimin e mësuesit me përvojë Jonuz Muça, bashkë me inxhinierët e prodhimit Jorgo Kola Hamza Gurra, Rustem Loka, Lazër Jaku, Përparim Hoxha, Todi Sena, Asllan Pata, Bashkim Lleshi e të tjerë. Shkolla e mesme e minierave pranonte nxënës nga Shupenza, Zerqani, Fushë-Bulqiza e nga fshatrat e Klosit(ata qqë siguronin banim tek të afërmit)Nga viti në vit shkolla rritej, shtoheshin klasa të reja me e pa shkëputje nga puna. U regjistruan në shkollë edhe gra e vajza në luftë me konceptet që i pengonin ato që të vazhdonin shkollën. Disa prej tyre u bënë inxhiniere pasurimi, ekonomiste, mjeke si lloreni Kola, Rolanda Dervishi, Evelina Tuma, Albana Alla, Donika Cani, Xhemile Gjoka, Hazbie Jella, Majlinda Shehu etj. Kanë mbaruar shkollën 1023 nxënës. Janë diplomuar 67 inxhinier në Universitetin e Tiranës. Mjaft të tjerë mbaruan fakultetet e mjekësisë, mësuesisë, juridikut e ato ushtarake. Krahas mësuesve vendas në këtë shkollë erdhën edhe mjaft mësues të rinj energjikë e të apasionuar si Andrea Simo, Ilir Belegu, Arben Sinoimeri, Bedri Karapici, Fatmir Zeraliu, nga Tirana Zija Ndrukaj e Mirjana Bekteshi nga Shkodra, Dhimitër e Tatjana Qurku nga Gjirokastra. Gjatë 25 vjetëve në këtë shkollë kanë dhënë mësim 158 arsimtarë. Ato së bashku me Osman Mihën drejtor i shkollës(1975-1990 kanë arritur për shndërrimin e shkollës së Bulqizës më të të dalluarat në rreth dhe në shkallë vendi. Ajo u bë qendra e përgatitjes së kuadrove të cilët për 15 vjet morën në dorë fatet e prodhimit të kromit. Pra të gjithë ishin nxënës që kishin kaluar nga bangot e kësaj shkolle. Ky ishte misioni i kësaj shkolle dhe pa e tepruar mund të themi se ajo e kreu me sukses atë. Janë të njohura nga të gjithë punonjësit e gjeologët e Bulqizës puna e mirë dhe rezultatet e sektorëve, brigadave dhe galerive që drejtuan për një kohë të gjatë Ilmi Manjani, Syrja Uka, Kalosh Jella, Agim Kacani, Bashkim Deda, Shpëtim Farruku, Destan Zeneli, Hajdar Pasha, Kadri Zeneli, dhe dhjetëra të tjerëve që me shembullin e tyre frymëzuan qindra minatorë të kromit pesha e të cilit njihet në ekonominë e vendit tonë. Shkolla bëri emër të mirë edhe në saj të ndihmës së madhe dhe të pakursyer që dhanë drejtuesit e Bulqizës si Martin Cukalla, Bujar Pata, Thanas Deda, Bajram Puca, Nazmi Përkola, drejtori I parkut Dibër në vitet 1976 Bajram Stojku(në bashkëpunim me minierën siguruan transportin e nxënësve falas) inxhinierët e prodhimit dhe institucionet e tjera të rajonit. Rezultatet e nxënësve të Bulqizës në fakultetin e gjeologji-miniera kanë qënë të mira, ato u bënë kuadro të zot, u bënë drejtues të aftë në Bulqizë por edhe në administratën e shtetit tonë si Agim Vargu, Vehbi Musta, Fadil Cani, Petrit Duva, Bajram Bruçi Nezir Lica, Afrim Okshtuni, Veli Losha, e Fiqiri Muça. Mjaft të tjerë janë zgjedhur përfaqësues të qeverisjes vendore e deri deputet në Kuvendin Popullor si Dilaver Deda e Kujtim Gjoka. Shkolla u bë qendër e gjallërimit të jetës qytetare, kulturore e artistike. Këto veprimtari, shfaqjet e organizuara në raste festash, gjallërimi I punës me librin, krijuesit e rinj, nën drejtimin e mësuesve të pasionuara Nafie Jella e Hajri Mandri i dhanë impulse të reja jetës letraro artistike të qytetit. Mjaft nxënës të kësaj shkolle kanë marrë pjesë në festivalet zonale e deri ato kombëtare si Fëllënza Çupi, Selim M. Alliu, Azem Teta, Defrim Mandri, Hide Jangulli etj. Të larmishme janë zhvilluar dhe veprimtaritë sportive. Pjesa më e madhe e ekipit 'Minatori" të Bulqizës ishin nxënës të shkollës si Njazi Koçi, Ilmi Cani, Ilir Disha etj. Marshimet, ngjitjet alpiniste në Dhoks, Majën e lepurit, Balgjaj, kampionatet e shahut, skive, festivalet e lojërave popullore midis shkollave të rrethit e ato kombëtare tregon për punën plot pasion të mësuesve Sabri Abdiu, Mukades Muça, Shemsi Qoku, Rami Hoxha e Ilir Disha. Një ambient i ngrohtë, dashamirës e tepër miqësor na krijuan ne mësuesve qytetarë e Institucionet për punën e jetën tonë të përditshme, që nga strehimi, shërbimet tregtare e shëndetësore, për të cilët jemi shumë mirënjohës. Mirënjohje e respekt për të gjithë ato njerëz me zemër të madhe e bujare, qe mbajtën lidhje me shkollën (nëpërmjet fëmijëve të tyre) duke na lehtësuar pa masë veprimtarinë tone edukative dhe të mësimdhënies. Më 1994 shkolla e Mesme e Minierave u mbyll. Kjo na brengos dhe me keqardhje na detyron të pranojmë humbjen e një eksperience që do të duheshin disa breza për ta ripërtërirë. Një pjesë e nxënësve kanë dalë në pensione dhe vit pas viti do të dalin të tjerët. Brenda 10-15 vjetësh i gjithë ky brez që vazhdon të punojë është i detyruar edhe për shkak të moshës të marrin pension pleqërie. Miniera është privatizuar, por kjo presupozon që kualifikimi i punonjësve të rritet gjithnjë e me shumë shto këtu edhe vështirësitë për punimet kapitale në thellësi (siç mësojmë nga inxhinierët që punojnë aktualisht në minierë), shkolla është domosdoshmëri dhe kërkesë imediative. Natyrisht rrugët, mënyra, funksionimi mbetet detyrë e organeve vendimmarrëse dhe kryesisht e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Aktualisht mund të themi se Misioni i Shkencës së Minierave të Bulqizës nuk ka përfunduar, ajo është ndërprerë në gjysmë të rrugës.

Mbyllet shkolla e mesme në Zalldardhë

Viti i ri shkollor edhe pse me mjaft mangësi ka nisur. Diku me turne për mungesë vendi e diku mungesë librash, diku mungesë kuadri e diku mjedise shkollore të shkatruara por kryesore është se shkolla ka nisur. Krejt ndryshe ndodhi në shkollën e mesme të Zalldardhës. Sivjet ndodhi një fenomen i papëlqyer për mjaft prindër e nxënës të kësaj shkolle. Një shkollë kjo si e Zalldardhës mjaft e hershme e ku sot numërohen me qindra e qindra kuadro që kanë dalë nga bangot e saj, mbyllet pikërisht në një kohë që të gjithë prisnin të festonin përvjetorin e saj. Kryetari i Komunës Njazi Cani shprehet se shkolla është mbyllur për mungesë të nxënësve. "Ka shumë pak nxënës që frekuentojnë shkollën e mesme. E kjo ka ardhur si rrjedhojë e lëvizjeve të mëdha demografike që nga Zalldardha mjaft familje vitet e fundit janë larguar drejt Tiranës e Durrësit. Nuk mund të mbajmë një shkollë si kjo me pesë apo gjashtë nxënës sa e frekuentonin". Mirëpo krejt ndryshe me kryetarin e komunës mendojnë prindërit. "-Shkolla është mbyllur për mungesë kuadri, thotë Ibrahim Ndreu. Vitet e fundit në këtë shkollë ka patur mungesë të madhe arsimtarësh. Sot detyrohemi që fëmijët t'i dërgojmë në Arras plot dy orë rrugë në këmbë. Vaj halli kur koha të prishet pasi dihet se tek ne bën dimër i ftohtë e me mjaft rreshje. Por si ky prind ka plot të tjerë të shqetësuar të cilët thonë se kur janë ankuar për mos hapjen e shkollës u kanë treguar dhe qytetin e Peshkopisë". "-Ka shkollë me konvikt në qytet na kanë thënë", shprehet Xhemal Hoxha. E kush i ka ato mundësi nga ne që të dërgojmë fëmijët në konvikt. Lekët që marrim nga asistenca në komunë nuk na dalin vetëm për librat e nxënësve. Po ne me çfarë do të ushqehemi? Po konviktin me çfarë do ta paguajmë? Megjithatë reagimet e nxënësve kanë rënë në vesh të shurdhër. Fakt është se shkolla e Zalldardhës ndodhet e mbyllur. -U pa puna, thotë Ibrahimi, ngaqë është godina në pronën time do ta marr vetë e ta bëj stallë për bagëtitë e mia. Ky qenka fati i kësaj shkolle, një ndër më të vjetrat në zonë ku vetëm pak disa vitesh gumëzhinte dhe vetë Zalldardha nga një mori e madhe nxënësish. Vinin edhe nga zona të thella si Kalis, Reç,Ujë e Mujë e Çidhën. E sot çelsat do të ndryshken e kjo shkollë një nga më vjetrat në zonë vështirë se hapet më. Jo vetëm shkolla por për prindërit dhe nxënësit e Zalldardhës edhe zyrat e komunës janë mbyllur, edhe zyrat e Drejtorisë Rajonale të Arsimit janë mbyllur. Ato nuk ka kush t'i pres.

50 vjetori i Shkollës 9 - vjeçare, Zogje

Në fillim të viteve 50 të shekullit të kaluar në të gjitha fshatrat e Grykës së Vogël ishin çelur shkollat fillore, në Shupenzë e Gjoricë shkollat 7 vjeçare. Me kërkesën e mësuesit patriot Abas Xhafa në shtator 1959 filloi mësimet klasa e pestë në një nga dhomat e shkollës fillore Kovashicë. U regjistruan kështu 17 nxënësit e parë në shkollën Unike (kështu quhej shkolla 7 vjeçare), nga fshatrat Zogje, Stushaj e Kovashicë. Në verën e vitit 1960 u ndërtua shkolla e re në Zogje me 4 dhoma mësimi duke u dhënë mundësinë edhe fëmijëve të Bllacës e Mazhicës të vazhdonin shkollën 7 vjeçare.

Fshatrat e Zogje të Grykës së Vogël njihen si arsimdashës e patriotë. Këtë traditë e çuan më përpara mësuesit e pasionuar si Abas Xhafa, Ramiz Leka, Osman Leka, Reme Tasha, Sul Xhafa, Hamdi Dumani, Ahmet Tomja, të cilët hodhën themelet e arsimit 7 vjeçar në këtë zonë. Në vitin 1969 u hap shkolla 6 vjeçare në Gjurras dhe më 1970 në Topojan. Nga këto shkolla shumë djem e vajza vazhduan shkollat e mesme në Vlorë, Shkodër, Tiranë e Peshkopi. Mjaft prej tyre u kthyen në punë si mësues, siç ishin Drita Lila, Dylbere Toci, Shqipe Leka, Avni Toci, Kamerr Xhafa, Zabit Lleshi, Gëzim Dumani,



Arian Kaja etj.

Më 1974 u hap shkolla e Mesme Bujqësore pa shkëputje nga puna, ndërsa më 1980 me shkëputje nga puna. Në Zogje kanë mbaruar shkollën 7 vjeçare 1730 nxënës, 650 të mesmen dhe 58 arsimin e lartë, ndër to afër 50 mësues.

Në shkollat e Zogje kanë kontribuar me punën e tyre mësues nga zona të tjera të rrethit si Ali Puca nga Zerqani, Hamdi Pira e Skënder Kuta nga Dibra e Poshtme, Zabit Shehu, Ivzi Muca, Hekuran Dida nga Maqellara, Dyrmish Shehu nga Sllova, Mendu e Latif Dema, Latif Manjani nga Homezhi, Hiqmet Tasha, Xhevat Jella e Skendër Zeneli nga Bllaca, Shukri Xheleka e Zabit Kaci nga Boceva.

Në saje të punës së lavdërueshme të këtyre mësuesve qindra nxënës mbaruan shkollat e mesme dhe të larta dhe kanë punuar nga infermierë, mësues, agronomë në fshat e deri në akademi, mjekë e profesorë në shkollat e mesme e të larta. Nazmi Suti, Bashkim Xhafa, Gani Toci oficere, Nazmi Kaja mjek (Doktor Shkencash) Sami Xheleshi, Flamur Meta agronom, Altin Dumani prokurore e tjerë. Kanë drejtuar institucione e sektorë të prodhimit e ndërtimit si Bashkim Dumani, Naim Xhafa, Rasim Daci, Osman Tomja, Shahat Krrusa, Lirim Lleshi etj.

Si ish nxënës dhe njëkohësisht mësues i kësaj shkolle (1968 - 1970) së bashku me bashkëvendasit e mi dhe brezat me të rinj kujtojmë dhe nderojmë me respekt në këtë 50 vjetor mësuesit: Abaz Xhafa, Ali Puca, Zabit Shehu, Ali Kaja, Hamdi Dumani, Hamza Manjani që janë ndarë prej nesh.

Ata sakrifikuan gjithçka që fëmijët e këtyre anëve tu mësojnë shkrim e këndim, ti edukojnë dashurinë për dijen, shkollën e Atdheun. Emri dhe veprat e tyre do të nderohen e respektohen brez pas brezi.

ZABIT LLESHI

Rruga Arbërit nr. 42
botime

Një libër me vlera shkencore dhe letrare, një kontribut i ri për folkloristikën tonë, një libër tavoline që duhet ta ketë në dorë çdo nxënës e student, çdo njeri i interesuar për të studiuar krijimtarinë popullore...

Botim me vlera shkencore për folklorin

Nga: **NAIM PLAKU**

Shënime rreth botimit të librit "Fjalori enciklopedik i trashëgimisë shpirtërore" të autorit Fejzulla Gjabri



Prej disa ditësh ka dalë në qarkullim libri i autorit Fejzulla Gjabri " Fjalori enciklopedik i trashëgimisë shpirtërore", një libër me vlera shkencore dhe letrare, një kontribut i ri për folkloristikën tonë, një libër tavoline që duhet ta ketë në dorë cdo nxënës e student, cdo njeri i interesuar për të studiuar krijimtarinë popullore, terminologjinë e saj, për të njohur gjurmuesit, mbledhësit e bartësit e kulturës popullore e kuptuar sa më mirë atë.

Për mendimin tim, ky botim, ashtu sic është emërtuar dhe nga autori, është një vepër enciklopedike, sepse na jep njohuri të përmbledhura për folklorin dhe folkloristikën në përgjithësi në trajtën e një fjalori dhe nga ana tjetër është dhe një fjalor terminologjik, sepse na shpjegon thjeshtë shumë terma të folklorit në të gjitha gjinitë dhe zhanrret e tij. Kjo e bën atë një vepër njohëse me vlera të dyfishta.

Që në faqen e parë na jepet përshtypja se kemi të bëjmë me një botim serioz, me një hulumtim të thelluar e profesonal, të kompletuar me një aparat shpjegues e sqarues për përdoruesin dhe na bind që autori ka bërë një punë të gjatë kërkimore, ka derdhur djersë e ka harxhuar kohë duke shfrytëzuar mundësitë dhe aftësitë e tij në këtë fushë. Pasi na jepen dy vlerësime dinjitoze për veprën (Prof. Dr. Yllka Selimi, Prof.Asoc. Anton Papleka), autori udhëzon lexuesin për përdorimin e materialit dhe fillon trajtesat me rendin alfabetik duke na dhënë shpjegime të sakta artikull pas artikulli për termat, bashkimet terminologjike dhe emërtimet popullore që ka përdorë tradita jonë e pasur folklorike nga shekulli në shekull, të dhëna të shkurtëra biografike për folkloristë të vendit dhe të huaj, personaltete të kulturës popullore në fusha të ndryshme të folklorit nga ai letrar, muzikor, dramatik, të llojeve e zhanrreve të ndryshme, studiues dhe interpretues vyrtuozë të këngës, valles e melodisë popullore, të riteve e zakoneve, të veshjeve dhe kulturës e krijimtarisë materiale folklorike në përgjithësi. Autori është treguar i vemendshëm dhe i kujdesshëm që të mos lëjë jashtë edhe detaje nga më të imëtat e kësaj terminologjie e sidomos ato që janë ndërtuar si bashkime të qëndrueshme frazeologjike: Agallarët e Jutbinës, këngët majekrahe, këngët e buta, të sokakeve, etj; Qit e prit, Vallja e Osman Tagës, e Daj Nazifit,etj. Po kaq i vemendshëm është treguar autori për të përfshirë në botim edhe termat e reja apo të huazuara kohët e fundit si edhe figura të njohura e pak të njohura për lexuesin që kanë dhënë kontributin e tyre në krimtarinë popullore e studimet folklorike duke përfshirë dhe amatorë të viteve të fundin në festivale e veprimtari të tjera folklorike. Kështu, krahas mbledhësve të hershëm të folklorit shqiptar e albanologëve të shquar si Nobert Jokli, Han, Reinhold, Majer, Jarnik, Majer, Pedersen,etj., kemi dhe folkloristë të shquar shqiptarë si Frang Bardhi, De Rada, Thimi Mitko të shek. XIX e gjer tek më të vonshmit a më të rinjtë folkloristë, mbledhësish e studiuesish të shquar të këtyre visareve të kombit si Z.Sako, Q. Haxhihasani, R. Sokoli,etj. Nga ana tjetër autori nuk ka lënë jashtë, por ka pasqyruar me dashuri duke gjurmuar hap pas hapi jetën e veprimtarinë e amatorëve të thjeshtë, bartësve e interpretuesve vyrtuozë të folklorit tonë brenda e jashtë vendit, të këngëtarëve, valltarëve, instrumentistëve e interpretuesve të krijimtarisë popullore në përgjithësi si Fitnete Rexha e Bik Ndoja, Nexhmije Pagarusha e Esat Bicurri, Liri Rasha dhe Fatime Sokoli, etj. në këngë, Besim Zekthi, Xhevahire Gashi, Zyber Ceni, etj., në valle, rapsodët Sokol Arifi apo Dervish Shaqo e plot figura të tjera të shquara do t'i gjejmë në këtë botim dinjitoz.

Unë e vlerësoj si një meritë të padiskutueshme të këtij autori, jo vetëm materialin e përzgjedhur me kujdes, por dhe mënyrën dhe formën e gatimit të tij, që nganjëherë, shpesh nga dëshira për të thënë sa më shumë, bëhen zgjatje deri në hollësira e jepet informacion i panevojshëm e i lodhshëm për lexuesin. Lexuesi e kupton se këtu cdo gjë është dhënë me masë, qartë, shkurt e bukur, pa lundruar në ujëra të dyshimta. Biografitë e personave janë dhënë po kaq shkurt duke mos lënë jashtë atë që është e qenësishme dhe e domosdoshme: formimin intelektual dhe vlerat artistike që shpalosi ky apo ai krijues, veprën që la pas apo atë që po ndërton, mjedisin ku u poq dhe u rrit ky talent. Kuptohet që kjo punë kërkimore nuk ka qenë e lehtë për autorin, të cilën, mendoj, se nuk mund ta bëjë kushdo, përvec një njeriu këmbëngulës, të përgatitur profesionalisht, me pasion e vullnet për ta kërkuar e gjetur krijimtarinë tek burimi, për t'i njohur dhe evidentuar bartësit dhe interpretuesit e kësaj krijimtarie. Kështu ka vepruar autori për të shpjeguar e dhënë mendimin e tij për rrënjët e disa baladave dhe, sidomos, të disa varianteve që bashkëjetojnë në trojet shqiptare si Balada e nuses së vdekur, e Vdekjes së trimit, Kënga e Rexhës, Kajka e cobaneshës, etj. Kështu herë pas here ndeshim në mendime shumë interesante për prejardhjen e disa krijimemeve të mirëfillta, të lashta apo më pak të lashta, por që kanë bërë një jetë intensive në shpirtin e popullit tonë ndër shekuj.

Aty - këtu autori hedh edhe disa hipoteza të guximshme duke shprehur mendimin e tij për prejardhjen, kohën dhe vendin ku lindën disa nga reliket e folklorit tonë letrar e muzikor, disa balada, këngë, ckël këngësh, përhapja që patën ato në trojet tona, përdorimi i instrumenteve muzikor, shtrirjen e tyre në këtë ose atë trevë, huazimet me fqinjët dhe ndikimet reciproke të këtyre dukurive. Në disa artikuj të "Fjalorit", për tema të vecanta të rëndësishme që duan shpjegime më të plota, është bërë një paraqitje më e gjërë dhe më e detajuar, sidomos për gjinitë e llojet e krijimeve popullore.

Autori është marrë që herët me studimin e folklorit. Ai jo vetëm që është një punonjës shkencor me merita në këtë fushë, një mbledhës i kahershëm i krijimtarisë popullore, por një njohës i folkloristikës dhe folklorit në përgjithësi. Ky është libri i tretë i tij për tema të ndryshme të folklorit tonë. Më parë F. Gjabri ka botuar dy vëllime me lëndë e studime folklorike si legjendat " Dri, o Dri " dhe " Tirana në legjenda e balada ", të cilat janë mirëpritur nga lexuesit. Që nga viti 1987 autori ka bashkëpunuar në organet shkencore, sidomos me organet e Akademisë së Shkencave " Kultura popullore", "Gjuha jonë", etj. duke botuar artikuj shkencorë, sidomos artikuj studimor për folklorin.

Edhe në ndërtim dallojmë disa risi që e bëjnë veprën më të plotë. Pas cdo artikulli, me shkronja korsive është dhënë dhe literatura, titujt e veprave dhe autorët e shfrytëzuar për këtë qëllim duke përcaktuar dhe faqen e burimit. Literatura e shfletuar nga autori na jepet plotësisht në fund të librit. Dhe këtu janë plot 525 burime bibliografike si libra për trajtesa të vecanta, monografi, revista shkencore, organe të shtypit të përditshëm dhe atij periodik, dorëshkrime, gjë që tregon se autori ka hulumtuar me kujdes dhe ka bërë një punë të përgjegjshme që do t'ju vlejë, padyshim, brezave të sotëm dhe të ardhëm. Duke gjykuar nga kjo vepër që F. Gjabri i jep sot lexuesit, na bind se, në të ardhmen, prej tij do të kemi të tjera vepra të arrira, sidomos për folklorin tonë, të cilin ai e njeh, e don dhe e vlerëson kaq shumë.

Me këtë rast desha të shpreh dhe një mendim për botimet e sotme në përgjithësi. Në morinë e librave që dalin cdo ditë në qarkullim, nga të gjitha gjinitë e llojet, vepra monumentale që nga ato të korifejve të mendimit më të cpërparuar shkencor ndër shekuj e gjer tek ato më vulgaret, më amatoret e më keqinformueset, më vjen keq që vemendja e lexuesit është shmangur e shpërndarë dhe, në këtë pyll botimesh me plot drurë të shtrembër e të kalbur, është zor të dallohet ajo që është më e bukura, më me vlerë, më e nevojshmja, gjithashtu, duke rrezikuar të kalojnë jashtë kësaj vemendje dhe vepra që janë ushqyese, të nevojshme për shtresa të ndryshme të shoqërisë sonë. Ndaj dua që t'i tërheq vemendjen lexuesit, se pikërisht kjo vepër që po promovojmë është sa ushqyese, aq dhe e nevojshme dhe e domosdoshme për studiuesit në përgjithësi dhe për ata që janë të etur për ta njohur kulturën shpirtërore të popullit tonë dhe krijimtarinë e vlerat e tij në tërësi.

Fjalori që na kishte munguar

Profesor Hasan Çipuri sikur ka lindur vetëm për të bërë fjalorë, në një kohë që e di mjaft mirë se sa mund e sakrifica kanë fjalorët. Ashtu si Fjalori serbisht-shqip, që u botua pesë vjet më parë, edhe Fjalori shqip-serbisht, që u jepet në dorë lexuesve, u përgjigjet kërkesave të vijueshme të studentëve të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë(dega gjuhë-letërsi shqipe) dhe të Fakultetit të Gjuhëve të huaja të Universitetit të Tiranës, ku prej vitesh mësohen gjuha serbe dhe ajo kroate, njësoj si edhe gjuhët e tjera ballkanike. Puna për realizimin e këtij fjalori ka qenë e lodhshme dhe e vështirë, sidomos për ndërtimin e shprehjeve të goditura dhe të njësive frazeologjike, të cilat zënë një peshë të madhe në të. Gjithashtu edhe më e vështirë ka qenë puna për diferencimin e fondit leksikor të serbishtes nga kroatishtja, të cilat për një kohë të gjatë kanë funksionuar si një gjuhë standarde, duke pasur si bazë të përbashkët të folmen shtokaike, por në dy shqiptime: ekavik dhe ijekavik. Nisur nga ngjashmëritë që kanë dy gjuhët në fjalë dhe bashkëfunksionimin e tyre për një kohë, autori i fjalorit, me gjithë përpjekjet e bëra për të pasqyruar në këtë fjalor leksikun themelor të serbishtes në ballafaqim me shqipen nuk mund të mëtojë se ka bërë një zgjedhje të paqortueshme, gjë që do ta kishin të vështirë edhe vetë gjuhëtarët serbë e kroatë. Ai ka bërë aq sa i kanë dhënë mundësi fjalorët e vjetër të serbishtes, e sidomos fjalori diferencues i kroatishtes me serbishten, botuar në vitin 1992 në Zagreb, të cilin e ka shfrytëzuar shtershëm. Po ashtu e ka ndihmuar shumë përvoja më shumë se 40-vjeçare e përkthimeve dhe e mësimdhënies në Universitetin e Tiranës dhe në institucione të tjera të vendit. Megjithatë, jemi të vetëdijshëm për lëshimet e bëra në ndonjë rast sinonimesh, për të cilat shpresojmë se përdoruesit e fjalorit do të na ndihmojnë me vërejtjet e tyre dashamirëse për t'i mënjanuar ato në botimet e ardhshme. Fjalori shqip-serbisht rrok 45.000 fjalëtituj dhe rreth 25.200 shprehje, frazeologjizma e fjalë të urta, të cilat do të japin ndihmesën e tyre në leksikografinë e gjuhës shqipe. Ai do t'u vijë në ndihmë përdoruesve të sferave të ndryshme profesionale, studentëve, përkthyesve dhe të gjithë atyre që janë të interesuar për të mësuar shqipen dhe serbishten. Fjalori përfshin pjesën dërmuese të fondit të Fjalorit të gjuhës shqipe të vitit 1980 dhe të fjalorit të shqipes së sotme, ribotimi i vitit 2003, fjalësit e fjalorëve shqip-gjuhë të huaja të botimeve më të fundit, si dhe një sasi fjalësh e termash të rinj shkencorë e teknikë, që janë futur në përdorim vitet e fundit në gjuhën shqipe si kalkë ose huazime të pranueshme përgjithësisht.



"Nëse kërkon që të torturosh dikë, mos e urdhëro të rrahë metalin në farkëtari, as mos e dërgo në punë të rënda në miniera, por jepi më mirë të bëjë fjalorë, kjo punë është më e rënda se të gjitha llojet e mundimeve të tjera"

J.C Scaliger
(Dijetar, filolog i shquar, 1484-1558)

Veç këtyre janë konsultuar një varg fjalorësh të shënuar në bibliografinë e këtij fjalori. Fjalët janë zbërthyer dhe janë ilustruar me shembuj të larmishëm përdorimi konkret e të figurshëm në të dy gjuhët përqasësh. Arritja e këtij fjalori në nivel shkencor u realizua falë punës vetëmohuese disa vjeçare të autorit por dhe ndihmës që i kanë dhënë me vërejtje dhe sugjerime si Prof.dr.Hajri Shehu në Institutin e Gjuhës e të Letërsisë,Dr.shk. Valentina Nestor, pedagoge në Departamentin e Gjuhëve Sllave e Ballkanike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja,Prof.dr.Emil Lafe, shef i Qendrës së Enciklopedisë Shqiptare në Akademinë e Shkencave të RSH,Dr.shk Ruzica Susnjara për ndihmën konkrete në procesin e hartimit të fjalorit. Autori në parathënien e këtij fjalori i falënderon të gjithë përzemërsisht. Ky është i pari fjalor i këtij lloji që botohet në vendin tonë i ndarë nga gjuha kroate. Fjalorët që na ka dhënë Prof.dr.Hasan Çipuri janë të shumtë sepse e gjatë është periudha që Hasani merret me fjalorë. Si një njohës i mirë i gjuhës serbokroatishte por dhe gjuhës angleze e ruse sot në duart e studiuesve shqiptar kemi një sërë fjalorësh me autor Hasan Çipuri si: Fjalori serbokroatisht ushtarak 1990, Fjalori shumëgjuhësh me ilustrime për fëmijë 2002, Fjalori serbisht shqip 2003, Fjalor (me bashkautor) të termave të llojeve të armëve dhe shërbimeve shqip-anglisht –rusisht 2003, Fjalor (me bashkautor) i termave ushtarakë të NATO-s anglisht-frëngjisht-shqip dhe anasjelltas 1997, Fjalor (me bashkautor) i termave të përgjithshëm ushtarakë shqip-anglisht e anasjelltas 2004. Autori ka në dorë edhe një fjalor shqip-kroatisht. Jo vetëm kaq. Edhe pse mosha ia ka zbardhur flokët Prof.dr.Hasan Çipuri ka mjaft material me vlera që presin dritën e botimit e shpresojmë që kjo ditë të mos jetë e largët.

teatri

Shtatë trupa teatrore nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia marrin pjesë në edicionin e tretë te festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2009"

Teatri "Skampa" i Elbasanit fiton titullin "Sulejman Pitarka"

JAVA E ATMOSFERËS SKENIKE

Nga data 12-17 tetor 2009 në Qendrën kulturore në Dibër të Madhe, nën patronatin dhe me financim të Komunës së Dibrës së Madhe e të sponsorëve tjerë, u mbajt Festivali "Teatri Shqiptar në Maqedoni- Dibra 2009" i teti me radhë, ku morën pjesë trupa teatrore shqiptare nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova.

Teatrot pjesëmarrëse ishin:

Teatri Kombëtar-Tiranë me shfaqen "Këngëtarja Tullace" të autorit E. Jonesko me regjisor Spiro Duni;

Teatri "Skampa" Elbasan me shfaqen "Kolonel Zogu" të autorit H. Bojcev me regjisor Alfred Trebicka;

Teatri "Bylis" Fier me shfaqen "Si rruar qethur" të autori B. Kozeli me regjisor Guri Koco;

Teatri Kombëtar-Gjilan me shfaqen "Seks rena dhe pata t'egra" të autorit V. Alen me regjisor Erëson Zymberaj;

Teatri "Dodona"-Prishtinë me shfaqen "Fund loja", të autorit S. Beket me regjisor Kastriot Saqipi;

Teatri Kombëtar Gjilan me shfaqen "Kënga e aktorit" të autorit A. Çehov me regjisor Muharem Sulejmani;

Teatri Kombëtar-Tetovë me shfaqen "Albanikum" të autorit dhe regjisorit Florent Mehmeti.

Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës së Madhe duke e deklaruar të hapur këtë festival, tha se: "Ky vit ishte vit i vështirë financiar por Komuna e Dibrës së Madhe me angazhimin e saj arriti të sigurojë mjetet e veta dhe nga sponsorë tjerë siç ishte Komuna e Strugës me në krye zotin Ramiz Merko, Postat e Maqedonisë, Aeroporti i Maqedonisë, Kombinati "Knauf", Banjat e Dibrës-Capa, dhe shumë biznesmenë të tjerë dibran. Kësaj jave Dibra do të jetë qendër e kulturës shqiptare, duke bërë një bashkim shpirtëror, me dëshirë që pas përfundimit të këtij festivali të largoheni me mbresa të bukura për bujarinë dhe zemërgjerësinë dibrane".

Ylber Nuredinin, drejtor i këtij festivali, shtoi se jurinë e këtij festivali e përbëjnë Prof. Nehat Mehmeti nga Shkupi, Drita Pelingu artisten e merituar nga Tirana dhe aktoren Emine Toska nga Prishtina. Kritikët e këtij festivali do të jenë Dr. Adriatik Kallulli, Prof. Selajtin Salihu dhe Nebi Islami.



Aktorët e teatrit "Skampa" të Elbasanit gjatë interpretimit në dramën "Kolonel Zogu", me regji të Alfred Trebickës

Pas kësaj u paraqit Teatri Kombëtar i Tiranës me komedinë nga E. Jonesko. Me regji të Spiro Dunit dhe me aktorët Roland Trebicka, Bujar Asqeriu, Mariana Kondi, Anila Bisha, Flaura Kureta dhe Mir Sina.

Pas shfaqes regjisori Spiro Duni për deklaroi se : "Tërë aktorët janë mjeshtra, e duan punën dhe aktrimin e kryen me sukses. Syzheja e kësaj komedie është jashtë poetikës së Aristotelit. Jonesku, Beket etj janë kundër ngjarjeve që pasojnë njëra tjetrën. Nëpërmjet zbavitjes mund të shkojmë tek thelbi, nëpërmjet teorisë që botën e komandon absurdi. Mesazhi i kësaj shfaqje është se deri sa botën e komandon absurdi ne do të jetojmë kështu. Fjalët e kanë humbur kuptimin në këtë botë, janë kthyer në lëvozhga tingujsh pa kuptim".

Spektatorët dibranë janë të mënçur dhe duartrokasin në momentin që duhet.

PREZANTIM I MAJAVE TEATRORE

Shfaqja më e mirë që fitoi çmimin "Sulejman Pitarka", u shpall "Kolonl Zogu" - Teatri "Skampa"-Elbasan. Regjisori më i mirë u shpall Kastriot Saqipi, për shfaqen "Fundloja" - Teatri "Dodona"- Prishtinë, aktorja më e mire që fitoi çmimin "Qemal Ajdini" u shpall Shengyl Ismajli, Teatri "Dodona" - Prishtinë dhe aktori më i mirë që fitoi të njëjtin çmim u shpall Roland Trebicka për rolin në shfaqen "Këngëtarja Tullace" - Teatri Kombëtar Tiranë.

Edicioni i tetë i Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2009" qe manifestim i këndshëm për tërë artdashësit dibranë dhe mysafirët pjesëmarrës. Secili artdashës do ta kishte dëshiruar të jetë në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë në Dibër të Madhe në këtë eveniment kulturor, ku u shfaqën 7 shfaqje.

Profesor Nehat Mehmeti, kryetar i jurisë gjatë shpalljes së fituesve, theksoi se: "Publikun dibran mund ta gjesh rrallë në këto hapësira dhe më gjerë. Juria mori vendim unanim që çmimin inkurajues tia japë aktorit Buhran Amiti, Teatri Kombëtar Tetovë. Çmimi aktorja joprotagoniste i jepet aktores Anila Bisha, Teatri Kombëtar Tiranë. Çmimi aktori joprotagonist më i mirë i jepet aktorit Salsano Rrapi, Teatri "Skampa" Elbasan. Aktorja më e mirë e Festivalit shpallet Shengyl Ismajli, Teatri "Dodona"Prishtinë , aktori më i mirë i Festivalit shpallet Roland Trebicka, Teatri Kombëtar Tiranë. Regjisori më i mirë i festivalit shpallet Kastriot Saqipi Teatri "Dodona" - Prishtinë. Çmimi special i Festivalit i jepet aktorit Luftar Pajo, Teatri "Bylys" - Fier. Shfaqja më e mirë e Festivalit, e cila fitoi çmimin "Sulejman Pitarka" u shpall "Kolonel Zogu ", Teatri "Skampa"-Elbasan. Me këtë rast u shpërblyen edhe kritikët Prof. Dr. Nebi Islami dhe Prof. Dr. Adriatik Kallulli, për kontributin e tyre gjatë tërë viteve që mbahet ky Festival.

Kritiku Nebi Islami duke u falënderuar për shpërblimin theksoi se, "Për tetë vite radhazi jam fisnikëruar sëbashku me ju, jam shumë më i begatshëm shpirtërisht. Në këtë festival e kam njohur popullin shqiptar pikërisht në këtë festival. Duke njohur shumë miq nga të gjitha trevat".

Ndërkaq kritiku Adriatik Kallulli, shtoi se, "Unë në Dibër të Madhe kam ardhur shumë heret, bashkëshortja ime është nga fshati Rostushë i Dibrës së Madhe. Dibranët janë të mrekullueshëm si publik dhe mërgimtarë të dalluar në tërë botën".

Argëtim Fida, duke deklaruar të mbyllur festivalin, tha se: "Falënderoj drejtorët e trupave teatrore, aktorët, regjisorët, kritikët, jurinë, stafin e festivalit, të cilët me përkushtim u angazhuan për organizimin dhe përfundimin sa më të mirë të këtij festivali. Dibrën e Madhe e bëjnë të madhe vetë dibranët, publiku dibran me kulturën, mikpritjen, zemërgjerësinë dhe bujarinë e tyre dhe me dëshirën për të respektuar vlerat e mirëfillta kulturore. Ky festival u mbajt në kohën e krizës botërore dhe patëm vështirësi financiare, të cilat i kapërcyen falë sponsorëve nga Dibra e Madhe dhe më gjërë. Dëshiroj që nga Dibra e Madhe të largoheni me mbresa sa më të mira. Ky festival do të mbahet me sukses edhe në të ardhmen".

Fituesve të çmimeve iu dorëzuan mirënjohje, skulptura artizanale druri dhe të holla.

Gjatë dorëzimit të çmimeve u thanë fjalë miradije për publikun dhe festivalin. Në pritje të vendimeve të jurisë para spektatorëve u shfaq një program artistik ku morën pjesë Pajazit Murtishi, artist mërgimtar nga Çikago e SHBA-së me monologun "Jam shqiptar" dhe Lejla Beqiri me flautë e Dritan Beqiri me klarinet, të cilët interpretuan pjesë të muzikës serioze.

Rexhep TORTE

- **Çmimi "Sulejman Pitarka": "Kolonel Zogu" , Teatri "Skampa", Elbasan.**
- **Regjisori më i mirë: Kastriot Saqipi, Teatri "Dodona", Prishtinë**
- **Aktorja më e mirë: Shengyl Ismajli, Teatri "Dodona", Prishtinë**
- **Aktori më i mirë: Roland Trebicka për rolin në shfaqen "Këngëtarja Tullace", Teatri Kombëtar Tiranë.**
- **Çmim inkurajues: Buhran Amiti, Teatri Kombëtar Tetovë.**
- **Çmimi aktorja joprotagoniste: Anila Bisha, Teatri Kombëtar Tiranë.**
- **Çmimi aktori joprotagonist më i mirë: Salsano Rrapi, Teatri "Skampa", Elbasan.**
- **Çmimi special i Festivalit: Luftar Pajo, Teatri "Bylys", Fier.**

DIBËR E MADHE -MIRËNJOHJE DIBRANO-AMERIKANIT SINAN FISHTA

Për kontribut vendlindjes

Udekorura dibrano-amerikani Sinan Fishta me mirënjohje për punën dhe veprimtarinë e tij të deritashme në të mirë të Dibrës dhe dibranëve.

Mirënjohja iu dorëzua në mjediset e myftinisë së Dibrës së Madhe, në praninë e kryetarit të Komunës Argëtim Fida, të kryetarit të Këshillit të Komunës, Nizamedin Papraniku, të Myftiut të Dibrës, Ruzhdi Lata, të kryetarit të Shoqatës "Votra Dibrane" në Dibër të Madhe, Shpëtim Cami, të kryetarit të Shoqatës "Atdhetare Dibrane" në Nju Jork, Ibrahim Kolari. Kjo mirënjohje iu dha me nismën e kryesisë të Shoqatës qytetare "Votra Dibrane" për aktivitetin e tij jetësor në promovimin e vlerave kulturore e shpirtërore dhe për zhvillimin ekonomik të qytetit të Dibrës së Madhe.

Me këtë rast fjalë miradie për Sinan Fishtën folën Argëtim Fida, kryetar i Komunës, Nizamedin Paprankiu kryetar i KK, Ruzhdi Lata,myftiu i Dibrës së Madhe dhe Ibrahim Kolari kryetar i SHAD në Nju Jork.

Shpëtim Cami kryetar i shoqatës "Votra Dibrane" në Dibër të Madhe dha një biografi për zotin Sinan Fishta.

Sinan Fishta duke u falënderuar për mirënjohjen dhe me urtësinë e tij dha rekomandimet e tij se suksesi jetësor i tij bazohej vetëm në dashurinë për Dibrën e tij dhe zhvillimin e këtij qyteti.

R.Torte



Rruga Arbërit nr. 42
kujtesë

Me rastin e 15 vjetorit të vdekjes

Elegji për Musa Sinën

Nga: **Prof. as. Dr. Bajram XHAFA**

Duke u endur me bllokun e shëni meve në dorë sa në një derë në një tjetër pas punëve të Legalitetit si ndonjë misionar endacak, një natë gushti të vitit 1992 më ra radha me bujt në Tiranë tek Musa Sina, si legalist (!). Jetonte me gruan e tij Mirvetin në një apartament pallati parafabrikat një dhomë e kuzhinë, marrë me qera njërit që sapo kishte emigruar. Shtëpinë e babait atje në fshatin Rreth-Kale të Dibrës, sepse gjatë jetës së vetë 62 vjeçare nuk pati rast të ngrejë as një kasolle, ja kishte shkatërruar prej kohësh pushteti komunist. Gjithë jeta i kishte shkuar në burg dhe internim. S'kishte tri vjet që ishte liruar.

Musa, kështu njihej në familjaritet, i përkiste kategorisë së burgaxhinjëve klasikë, një cilësor diskriminues i komunizmit, mbytës, ende me pushtet të fortë moral dhe politik. Fjalën "klasik" e themi në kuptimin veteran burgjesh, d. m. th. nga fillimi në mbarim të sistemit: 1945-1989, burg i pandërprerë, unik në kohë, njëcopësh. E kishte fillu ar në fillim të pranverës kalendarike dhe të pranverës së sistemit, në mars 1945, por edhe në fillim të pranverës së jetës së tij, kur sapo mbushte 15 vjeç. Dhe e mbyllte "ciklin" në fundin evropian të dimrit komunist - 1989. Burg politik me ngarkesë të plotë. Kësaj i them fat.

Kur fëmija mbush moshën e lakmuar 15 vjeç, fantazia lodron me harbim. Në atë moshë marrin vrull ëndërrat më të pafajshme e më të bukura për jetën. Prandaj fëmijëria është kaq e pushtetshme e sovrane. "Çdo të bëhem kur të rritem" ishte tema e preferuar e mësuesve të leximit letrar dikur që na e jepnin si temë hartimi në shkollë. Natyrshëm ishin edhe brenda orientimeve të propagandës zyrtare dhe kornizave ideologjike. Pikërisht në këtë moshë Musën e marrin dhe e çojnë në...shkollë?...ushtar?... luftë?...bari në mal? Jo, asnjëra nga këto. E shpien në...internim. Internimi do t'i shërbente si fazë përgatitore, si "stazh" maturimi, që, pasi të mbushte moshën, të merrte përgjegjësi më të mëdha, në... burg. Për sistemin e ri që sapo kishte hyrë, kushtet politike i plotësonte si më i miri.

Jeta e Musës mund të karakterizohet edhe si integrale, por nuk është e drejtë të thuhet se ka qenë krejt monotone. Nëse leksiku i shqipes nuk ka fjalë tjetër, po të lëmë mënjanë 15 vitet e para të fëmijërisë (1930-1945 nga dita e lindjes deri kur filloi "riedukimin" komunist), për 45 vitet e socializmit enverist jeta e tij, nëse mund të quhet "jetë", ishte alternuar në dy pamjet e saj kryesore, megjithëse, thuajse të një ngjyre, si e zeza me grinë e errët: internim-burg dhe anasjelltas, ndarë në afate thuajse të barabarta. Fundi i fundit, jetë dyngjyrëshe, me variete, pluraliste?! Hoh!. Qysh nga mosha kur njeriu i gjorë, si i thonë fjalës, bien në mend e veta, jeta e tij, e tëra: terr e zi. Në respekt të fjalës "integrim" për rastin e Musës mbase mund të përdoret edhe togjalëshi "burg integral".

Sidoqoftë, më në fund e më në san, edhe për Musën erdhi dita e shumëpritur: të gëzonte lirinë e "fituar" që tashmë nuk kish ç'i duhej. Ishte i tejngopur nga kjo jetë.

E kisha takuar për herë të parë më 17 nëntor 1991 kur erdhi në Shkodër bashkë me një grup të diasporës që ktheheshin "triumfalisht" nga Amerika dhe Belgjika në atdheun e tyre pas një emigrimi të stërgjatë. Emëri dhe pamja e Musës së vogël vendas humbiste para atyre të "diasporës euro-atllantike", ardhur nga Nju Jorku dhe Brukseli, grup në të cilin bënte pjesë edhe vëllai i tij, Rasimi, arratisur qysh më 1956 dhe vendosur në Sh.BA. Musa nuk bënte pjesë në "delegacion". Thjeshtë i bënte shoqëri të vëllait.

Po kush ishte në të vërtetë Musa, Musa Beqir Sina? Cila ishte familja Sina? Cili qe shkaku i atij fati mynxyrë?

Shkaku?! Ah, shkaku. Shkaku është...Shqiptari dhe fati i tij. Ka shumë shkaqe. Nuk është një i vetëm. Dhe fillojnë herët ato...Por ne po marrim ato më të vonëshmit. Le t'i kapim gjërat me themel, në gjenezën e tyre.

Sinajt ishin nga fshati Rreth-Kale e zonës së Muhurrit të Dibrës. Historia e tyre në gjysmën e parë të shekullit të '20 ishte e lidhur shumë ngushtë me ngjarjet që çuan në ngritjen e stërmundimshme të shtetit të parë shqiptar dhe kishte derdhur jo pak gjak për të. Kjo përbën edhe hipotekën e fatit të mëvonshëm kur erdhi diktatura.

Vëllai i Beqirit, mixha i Musës, Dika (Sadik Sina) ishte vrarë në Luftën e Kakarriqit në tetor 1912 në përleshje me ushtrinë malazeze kur 2000 forcave vullnetare të Matit e të Dibrës u printe Ahmet bej Zogu në përpjekje për të ndalë furinë e ushtrive shoviniste sllave mbi trojet shqiptare në Luftërat Ballkanike (1912 - 1913). Në këtë betejë u vranë mbi 80 vetë, matjanë e dibranë. Një në dorë. Gjyshi i Musës, Rushit Sina në luftërat kundër serbëve kishte marrë 7 plagë dhe kishte vdekur më 1925 nga një lëngatë e rëndë. Në vitet 1920-1924 kishte qenë në trupërojen e Ahmet Zogut. Dy në dorë. Vëllai i tij (i Rushitit) Lush Sina aty nga viti 1922 ishte vrarë në përpjekje me forcat rebele të Bajram Xhanit, ky i fundit dikur edhe me forcat e Haxhi Qamilit. Tre në dorë.


I jati i Musës, Beqir Rushit Sina i lindur më 1900, gjatë periudhës së Mbretërisë kishte qenë oficer i xhandarmërisë me gradën toger. Kishte shërbyer si rreth/komandant në vise të ndryshme të shtetit shqiptar: Homesh, Tepelenë, Shijak, Dukagjin (Kodër Shëngjergj). Në prag të agresionit ushtarak italian kundër Shqipërisë, forcat vullnetare të Muhurrit, mbi 150 vetë u nisën për ta pritur me luftë okupatorin. I mirënjohuri Dine Hoxha, pari me autoritet i zonës kishte vdekur më 1938 dhe tani drejtimin e forcave vullnetare e rezerviste e morën në dorë Ramadan Hoxha (nipi i Dines) dhe Beqir Sina (komandant) gjysëm pari. Në grup u nisën bashkarisht edhe paritë e Çidhnës: Kaloshet e Çidhnës, Selim e Miftar Kaloshi, Dervish Lusha, Qazim Lusha, Haxhi Noka, Osman Lita i Kalasë së Dodës. Pas tyre me forcat e veta të shumta vinte Cen Elezi, që njihej si kundërshtar i Mbretit Zog, por kjo nuk llogaritej. Hatri i atdheut ishte më i madh. Forcat vullnetare të Dibrës së Poshtme arritën deri në Qafë Shtamë, dikush deri në Krujë e një pjesë deri në Burrel, por u kthyen mbrapa kur morën vesh se ushtritë italianë kishin hyrë në Durrës, Shëngjin, Vlorë e Sarandë, tregon Musa. Katër në dorë. U bënë shumë, s'i mban dora.

Kur në Shqipëri u vendos "pushteti popullor", familja e Beqir Sinës nisi "jetën e re"; do të provonte një fat të ri. Epokë e re, kismet i ri. Devër dynjaja. Më 1945 familja e Beqir Sinës mori rrugën e internimit, fillimisht në Berat. Me të ishte edhe Musa që sapo kishte mbushur 15 vjeç. I zoti i shtëpisë, Beqiri, nuk ishte në këtë eveniment apo sebep pranë familjes. Ishte në mal i arratisur, kaçak. Në përpjekje me repartet e ndjekjes ai u vra më 13 shkurt 1946 në katundin Lukan të Dibrës bashkë me Elez Kalinë. Në përleshje e sipër plagoset rëndë dhe, si harxhoi të gjithë fishekët, të fundit e kishte ruajtur për vete për të mos rënë i gjallë në duart e komunistëve. Gjashtë në dorë? Ah, kjo nuk durohet. Më tej nuk ka më nevojë për numërim.

Vëllai i Musës, Feriti, djali i madh i Beqirit, në fillim kishte luftuar bashkë me Dan Kaloshin në radhët e Brigadës V S. Dan Kaloshi e Cen Elezi u larguan nga Nacionalçlirimtarja dhe, në prill të vitit 1946 u arratisën në Jugosllavi. Vëllai tjetër i Musës, Rushiti, djali i dytë i Beqirit (sipas radhës), bashkë me Feritin ikën fshehurazi nga internimi dhe në shtator 1948 u arratisën në Jugosllavi. Atje i vranë jugosllavët sëbashku me Cen Elezin, Dan Kaloshin, Haqif Nokën, Bilal Kolën me vllazën. Vëllezërit e tjerë të Musës: Rasimi, Hashimi, dhe Besimi, pasi u liruan nga internimi, qendruan pakë kohë në fshatin e tyre Rreth-Kale, (shtëpia ishte ndjegur nga partizanët më 1944) dhe në vitin 1956 arratisen në Jugosllavi.

Të kthehemi tek heroi ynë: Musa.

Që nga 11 marsi 1945, pranvera (socialiste!) në të hyrë, thotë Musa, kam qenë i internuar në Berat. Aty filloi jeta e tij e re standard, e rimuar sipas vargëzimit dyshe e alternuar A-B, A-B (internim-burg, internim-burg). Pati edhe vargëzim B-B-B (burg-burg-burg), por kjo është çështje "stili", "stilistikë" fati.



Gruaja e Musa Sinës, dhe tre fëmijët : Djali Bashkimi dhe dy vajzat, Markela dhe Kafilja, në kampin e interrnimit në Savër - Lushnje, (Nëntor - 1990) Musai mungon në foto, mbasi kur është bërë kjo foto ai ishte në burg dënuar me 9 vjet heqje lirie / neni famëkeq 55. Musai u dënua 3 herë dhe bëri 24 vjet burg gjithësejt.



Në fillim na shpunë në Berat, pastaj në Tepelenë, më pas në Lushnje, në Porto Palermo, vazhdon të ligjërojë Musa për "gjeografinë e kalitjes revolucionare". Nga Tepelena më hodhën në Tiranë e prej aty më 1952 në burgun e Burrelit, vazhdon ai. Pas 15 vjetëve burg në Burrel, duke futur këtu edhe një tentative për arratisje (si intermexo), më çuan në internim. Atje u martova, linda tre fëmijë dhe më 1979 rashë përsëri në burg të cilin e kreva: 3 vjet në Spaç të Mirditës, 3 vjet në Ballsh, pastaj në Zejmen e Sarandë, nga dy vjet secili. U lirova më 1989 pasi e plotësova me "nder" krejt dënimin. El hak. Ja pagoi hakun Partisë deri më një, deri në kacidhen e fundit. Nuk i mbeti asnjë fije borxh. Fat el hak, derman aspak. Pasi luftoi me një qetësi olimpike një mijë e një sëmundje, që i ranë nga qielli, toka e nëntoka, në korrik 1994 e mbylli me finalen hyjnore. Me Dhimë e Stimë, Musë! Zoti të dhashtë rahmetin e asaj dynjaje!

* * *

Me thesin e halleve të Legalitetit në krah, në tetor 1992 trokita prapë në derë të Musës, tashmë më tepër si mik se sa si "legalist". Fluturonte kur i vinin miq. Shkrihej i tëri. Shpirtin ta jepte. E pyesja për jetën e burgut dhe ai zbrazte gjithë dhimbjen e "përvojën" e tij kapitale dhe, mbase në këtë mënyrë e nxirrte atë jashtë. Mua, që më 1973-shin i kisha shkuar hapsanës në teh të briskut, më bëhej shpirti sa një gogël, si ai që sapo i ka mbyllur derën stuhisë kur vjen nga jashtë i mërdhizur e tkurrur dhe ledhatoja me ëmbëlsi perëndinë e fatit që më kishte shpëtuar. Ndërsa Musa tregonte ato të tijat, unë mendoja kohën e Plenumit IV dhe thoja me vete: Zoti është i madh. Shyqyr, më kishte shpëtuar për fije të perit.

- Musë, si ishin ushqimet në burg, cila ishte normative ushqimore për një të burgosur?

- Musa: Në 24 orë për çdo të burgosur llogariteshin 100 gram oriz ose makarona ose groshë dhe 6 gram vaj. Bukë 600 gram në ditë. Në mëngjes kishim një ujë të ngrohtë si çaj, por pa sheqer. Kjo ishte normativa nga ana teorike. Në realitet...gjeje vetë!

M'u kujtua një informacion tek Historia e Sotme, tekst për shkollat e larta i viteve 1980, të cilin e përdornim si material zyrtar në leksionet me studentët. Në zbatim të politikës së Komunizmit të Luftës në maj 1918, (politikë që e zbatoi edhe Shqipëria komuniste deri më 1949) Qeveria Sovjetike nxorri dekrete për vendosjen në vend të diktaturës për sektorët ushqimorë. Rezultati: lufta për bukën doli në plan të parë; për partinë dhe shtetin sovjetik ajo ishte luftë për mbrojtjen e rendit socialist. Në Petrograd e Moskë filloi të racionohet buka deri në 50 gram për çdo dy ditë. Hajde merre vesh se si mund të ndahet në praktikë "gjithë" ai racion teorik prej 50 gramësh në dy ditë për person. Ato milionat e vdekur nga uria në Rusinë sovjetike, frut i revolucionit të lavdishëm leninist të atyre viteve nuk përmendën në tekst. Kështu edhe ajo puna e racionit të Burgut të Burrelit me shifrat që më tregonte Musa. Përvoja e paçmuar sovjetike nuk mungonte.

* * *

Demokracia i dha Musës një shtëpi, dy dhoma e kuzhinë në një pallat të ri tek Kinostudioja "Shqipëria e Re". Pallati ishte vetëm për ish të burgosur. Një kafaz hekuri fi-12 realizonte sigurimin e shkallës në hyrje të saj nga keqbërësit e mundshëm. Një psikologji dhe dekoracion burgu. Shkova t'ia uroj. Nuk mund të jetojmë pa u rrethuar me hekura si ato të burgut, më tha duke qeshur. Simbolikë burgu, thashë me vete. Kudo që të na shpien, ne burgun e marrim me vete. Jeta jonë nuk mund të mendohet ndryshe.

Ndonjë dekoratë?! Ndonjë "Martir i Demokracisë" apo "Pishtar i...". Nuk jam i sigurtë nëse pati fat ta marrë apo t'ia japin. Fundja, ç'i duhej? Edhe po t'ia jepnin, ai do t'ia falte ndokujt që të kishte më shumë nevojë për të, ndonjë deputeti, ministri për "pasuruar" kurrikulën.

Vdekjen e ndjente se do t'i vinte së shpejti. E shihte se po i soseshin varrat. Kishte hall që trupi të dilte nga shtëpia e tij. Nuk jam i sigurtë sa netë fjeti në atë shtëpi, në shtëpinë e tij, ndoshta ndonjë javë, ndoshta më pak. Shpejt ra në spital ku edhe kishte vdekur. Mbase e nisën direkt nga spitali për në Dibër, ku do të varrosej.

Epilog

Edhe për Musën, ashtu si për të gjithë njerëzit e kësaj toke, të pasur apo të varfër, të pushtetshëm a të pa pushtetshëm, të lavdishëm apo të pa lavde, erdhi finalja, e patjetërsueshmja, universalja. Më 24 korrik 1994 Musa i dha lamtumirën kësaj bote.

Për varrimin e Musës më treguan. Në atë ceremoni kishin qarë edhe gurët. Të kishte vdekur në moshën 15 vjeç nuk do të ishte qarë dhe aq për të. Çfarë t'i qaje më parë. Nuk i qaheshin hallet. S'kishte gjyshe Lure që t'ia njehte dertet. Arkivolin me një grusht kocka të kallur brenda e kishin sjellur vërdallë përreth rrënojave të shtëpisë së dikurshme ku ishte lindur dhe parritur ende' në ato 15 vjetët e Perëndisë. Sillej si fantazëm një jetë e rrënuar përreth mbeturinave të një shtëpie të rrënuar, të një populli e kombi të rrënuar. Një procesion makabër. Vallë, kujt ja zuri Diellin Musa i Vogël? Kujt ia zuri Diellin Shqipëria e Vogël apo e Madhe? Pse, mbi këto çandra u mbaka siguria dhe paqa evropiane? Mbi kokallat rakitike të Musës së Vogël e të popullit të tij qenka ngritur ekuilibri dhe siguria evropiane në Kongresin e Vjenës (1815), të Berlinit (1878), në Konferencën e përbindshme të Londrës (1913), në Konferencat e Versajës (1919, 1946), që mallkuar qofshin. Pax Europeanea. Në qoftë kështu, flaka iu dhashtë.

Pastaj arkivolin me trupin e tij e kishin vënë në varrezat e fshatit ku prehet përjetësisht buzë Drinit nën mërmërimat vajtimtare të valëve të tij.

Me dhim(b)ë e stimë, o Musë.

Shkodër, 2009

Ku gjenden eshtrat e patriotit **Dr.Nexhat Agolli**?!

Apel për të gjithë ata që dijnë për këtë vrasje mizore

Nga: **REXHEP TORTE**



Shëmbëlltyrat patriotike e nderojnë vetveten me guximin dinjitoz ndaj të keqes kombëtare. Ne, pasardhësve të tyre, na takon obligimi për të vënë dritë mbi padrejtësitë dhe krimet që u janë bërë këtyre shëmbëlltyrave patriotike. Kryerja e këtij obligimi do të na nderojë në emër të kombit, ndërsa keqbërësve do tu tregojë se krimeve u vjen koha të dalin në shesh.

Në këtë rrugë të zbardhjes së të vërtetës është duke kaluar edhe figura e patriotit dibran e mbarë shqiptar, Dr.Nexhat Agolli, ish z/v kryeministër në Qeverinë Maqedonase të pasluftës së Dytë Botërore.

Krimet që mundohet t'i mbulojë historia, përpiqet t'i zbardh këmbëngulësia dhe etika vëllazërore e njerëzore. Kështu do ta fillonim ne këtë tregim të dhembshëm për dibranin Nexhat Agolli, të cilin UDB-ja Jugosllave e burgosi, e torturoi, e masakroi deri në vdekje dhe e varrosi në fshehtësi.

Në Shoqatën e të burgosurve e të dëmtuarve politikë shqiptarë në Maqedoni-Dega në Dibër, në vitin 2005 arriti një shkresë e autorizuar dhe e vërtetuar në noteri në Tiranë. Nëpërmjet kësaj shkrese, Mahmud Agolli, i lindur në Dibër të Madhe në vitin 1920 dhe tani banues në Tiranë, e autorizon shoqatën e sipërpërmendur që të ndërhyjë te organet përkatëse të Republikës së Maqedonisë, për të gjetur eshtrat e vëllaut të tij Nexhat Agolli, ish z/v kryeministër e Ministër për Çështje Sociale i Maqedonisë, dhe për tu rivarrosur në Dibër të Madhe.

Në këtë letër shkruan se: "Nexhat Agolli është lindur në Dibër të Madhe në vitin 1914. Ka kryer studimet dhe është diplomuar për drejtësi në Romë të Italisë. Gjatë okupacionit nazifashist ka qenë gjykatës në qytetin e Gjakovës në Kosovë. Në vitin 1943 ka braktisur detyrën e gjykatësit dhe është radhitur përkrah forcave partizane. Me porosi të Shtabit partizan të Dibrës sëbashku me shokët Demir Gashi, Ilmi Çausholli dhe Qemal Agollin, ka përhapur rezistencën antifashiste te populli shqiptar në Maqedoni dhe ka punuar e luftuar deri sa ishte gjallë. Gjatë LANÇ Nexhati është plagosur dy herë në luftë kundër gjermanëve. Me rastin e vrasjes së komandantit Tom Nikë Gjela, me nofkën Shumski, me disa shokë tjerë e kanë nxjerrë trupin e të ndjerit nga sheshi i luftimeve dhe e kanë varrosur në periferi të fshatit Zogaj në Kërçovë. Nexhat Agolli gjatë luftës partizane ka pasur përgjegjësi të ndryshme, deri komandant brigade. Pas çlirimit ka qenë anëtar i Qeverisë së Maqedonisë në detyrën e z/v. kryeministrit dhe Ministrit për Çështje Sociale, derisa u arrestua.

Nexhat Agolli në burgun e Shkupit është torturuar vazhdimisht deri sa në fund është masakruar për vdekje, pa një vendim gjyqësor".

Bashkim Mashkulli, z/v kryetar i Shoqatës së të burgosurve e të dëmtuarve politikë shqiptarë në Maqedoni, lidhur me shkresën e dërguar nga Mahmud Agolli, shprehet se: "Ne si shoqatë e të burgosurve dhe të dëmtuarve politikë shqiptarë në Maqedoni, iu drejtuam me shkresë Avokatit të popullit dhe partive politike shqiptare, për të gjetur vendin ku e kanë varrosur Nexhat Agollin dhe eshtrat e tij t'i rivarrosim në Dibër, vendlindjen e tij. Apeluam gjithashtu te të gjithë qytetarët e Maqedonisë që dinë apo kanë dëgjuar për vendin e varrimit të Nexhat Agollit, t'i paraqiten shoqatës sonë. Për fat të keq sot e kësaj dite nuk kemi asnjë informatë."

Në vitin 1999 u shënua 50-vjetori i vrasjes së Nexhat Agollit, ku morën pjesë historianë e veteranë të luftës nga dy Dibrat.

Në këtë akademi përkujtimore, u fol se: "Nexhat Zija Agolli u lind në Dibër të Madhe në vitin 1914 në një familje me tradita atdhetare. Mësimet e para i merr në Krumë të Kukësit në vitin 1928. Pastaj regjistrohet në Shkollën tregtare të Vlorës ku tregon rezultate shumë të mira, sjellje shembullore dhe vullnet të fortë për të mësuar. Mes 44 dëshmorëve ish nxënës të kësaj shkolle vend nderi zë edhe Nexhat Agolli. Ai përshkruhet jo vetëm si nxënës shembullor, por edhe si i shquar në manifestimet kulturore e artistike.

Pas shkollës tregtare të Vlorës vazhdon vitin e fundit në Gjimnazin e Tiranës për tu regjistruar pastaj në studimet e larta në Romë. Atje kryen studimet me notë të shkëlqyeshme dhe emërohet asistent në fakultetin e drejtësisë në Romë, por i shtyrë nga ndjenja e atdhedashurisë kthehet në Shqipëri. Djaloshit dibran i qante zemra për shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë që kishin mbetur jashtë Shqipërisë.

Nexhat Agolli me ardhjen në Dibër të Madhe bëhet figurë e njohur në popull. Dëshmohet si luftëtar i paepur, drejtues dhe organizator i aftë, sa që edhe vetë udhëheqësit maqedonas shpreheshin, "Në asnjë nga brigadat tona nuk kemi parë intelektual dhe trim si Nexhat Agolli". Edhe pse ishte komisar e komandant në fushën e betejës veten e konsideronte si partizan i thjeshtë. Dy herë u plagos por nuk u tërhoq asnjëherë nga lufta.

Gjatë veprimtarisë së tij revolucionare Nexhati punoi edhe si gjykatës në Gjakovë, ku u njoh me anëtarët e LANÇ, Emin Duraku, Xheladin Hana etj. I ndjekur nga xhandarmeria, ai kthehet sërish në Dibër të Madhe. Më vonë emërohet edhe z/v komandant i batalionit të zonës së Kërçovës dhe merr pjesë edhe gjatë luftimeve për çlirimin e zonave në Kumanovë, Preshevë, Bujanovc, Gjilan e Shkup".

Nexhat Agolli pas çlirimit të vendit për merita ushtarake, politike dhe organizative emërohet z/v kryeministër dhe Ministër i Asistencës sociale në Qeverinë e parë të Maqedonisë. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave shqetësimi i tij kryesor ishte hapja e shkollave shqipe në mbarë Maqedoninë ku jetonin shqiptarët.

NDJEKJA NGA UDB-JA DHE ARRESTIMI DHE VRASJA NË QELI

Në këtë akademi përkujtimore duke u hedhur dritë për vrasjen e këtij martiri të kombit, u tha se: "Puna që bënte Nexhat Agolli nuk i pëlqente UDB-së jugosllavo-maqedonase, e cila filloi ndjekjen dhe survejimin e vazhdueshëm. Kështu, që një mbrëmje në orët e vona të natës u bë rrethimi i shtëpisë së tij ku banonte sëbashku me familjen. E kuptoi menjëherë se kishin ardhur për ta arrestuar. Rrëmbeu mitralozin dhe armët që kishte dhe zuri pozicion në dritare. Në momentin që do të hapte zjarr, bashkëshortja me lutje i thotë të heqë dorë, pasi do tu vrisnin edhe fëmijën. Nexhat stepet për disa momente, në atë moment futen brenda policët e UDB-së. Pasi e burgosin në qelitë e burgut, udbashët përdorin metodat më barbare për ta gjunjëzuar e mposhtur, por Nexhati u reziston torturave dhe shpifjeve. Në këtë skëterrë titiste lidhet me një student të dënuar 6 vjet burgim. Kjo lidhje mes tyre vendoset nëpërmjet një vrime të hapur në murin e përbashkët. Studenti i dëgjonte të gjitha torturat që barbarët ushtronin mbi trupin e gjakatosur të Nexhatit, të cilat kulmin e arritën në datat 20 deri 29 prill 1949 kur u shua jeta e këtij atdhetari shqiptar.

Gjatë vrasjes barbare të Nexhat Agollit, udbashët përdorën edhe thikat, pasi nga qelia e tij doli shumë gjak, edhe dysheku i tij kullonte nga gjaku. Nexhat Agolli u masakrua në burgun "Shutka" të Shkupit. Pastaj trupi i tij u nxor në "Plloshtad-in" e Shkupit i bërë shoshë edhe nga plumbat, për të inskenuar se gjoja Nexhati është vrarë gjatë tentimit për tu arratisur".


Kështu e mbylli jetën e tij të shkurtër patrioti dhe intelektuali Nexhat Agolli në dobi të shqiptarizmës dhe atdhedashurisë. Populli i Dy dibrane derdhi lot pikëllues për birin e tyre, bile i thuri edhe vargje.

"Një natë prilli dyzet e nëntë, / Mbas torturash që i banë, / Pushk'e tradhtarit titovjan, / Vret Nexhatin si asllan...".

Ky tekst le të shërbejë edhe si një apel i dytë për të sensibilizuar kërkesën për gjetjen e varrit dhe të eshtrave të këtij patrioti shqiptar, sepse ai u torturua dhe u pushkatua mizorisht në sheshin qendror të Shkupit.

HOMAZH

Tetë vjet pa intelektualin **Ramazan Hoxha**



Kanë kaluar më shumë se tetë vite që atëherë. Fëmijët tashmë janë rritur e nënë Arzja është plakur më shumë, por malli për djalin e saj të vdekur nuk është shuar nga zemra e saj. Atë ditë Ramazan Hoxha doli si çdo herë nga shtëpia duke u përshëndetur me nënën, vëllezërit, gruan e fëmijët. -Do të kthehem shpejt, ndoshta dhe më herët se ditët e tjera. Vjeshta kishte ardhur e gjethet e pemëve kishin filluar të binin. Nëna e priste tek porta se do të kthehej herët por eh fati nganjëherë nuk qëndron me njerëzit e mirë. Një aksident tragjik i mori jetën në moshën më të mirë ku prej tij prisnin jo vetëm gruaja e fëmijët por dhe nëna e vëllezërit e tij. Data shënonte 11 tetor 2001, një datë kjo që nuk hiqet kollai nga kujtesa për familjen Hoxha. Vetëm dy vjet më parë kishte vdekur Vexhiu, babai i Ramazanit, një njeri i mirë që i ishte përkushtuar gjatë gjithë jetës së tij fesë islame. Ramazani lindi në fshatin Blliçe në vitin 1958 në një familje të persekutuar nga sistemi por të nderuar jo vetëm në Blliçe por dhe jashtë saj falë respektit që kishte krijuar babai i tij Vexhi Hoxha. Nëna e tij Arzja ishte bijë e Rustem Bitrit i pushkatuar në vitin 1946, kështu për fëmijët e Vexhi Hoxhës ishte i vështirë arsimimi pasi hija e frikshme e luftës së klasave endej në të gjithë Dibrën ato vite. Vexhiu si njeri i ditur dhe mjaft arsimdashës e kishte këtë plagë për të arsimuar djemtë e tij të cilët kishin filluar tashmë të rriteshin e të përfundonin shkollën e fshatit. Sjellja e mirë si familje, respekti që kishte e gjithë zona, figura e spikatur e Vexhiut si dhe notat e mira që kishte marrë bënë që Ramazanit t'i dilte bursa për zooveteriner,ku fill pas diplomimit e caktojnë në Fushë-Çidhën. Nuk ishte e lehtë të punoje në ato vite në Fushë-Çidhën e sidomos për Ramazanin i cili ishte pa përvojë e në moshë të re. E megjithatë ka mjaft shokë e koleg të tij që sot pas kaq vitesh flasin për personalitetin e Ramazan Hoxhës në ato vite në Fushë - Çidhën. -Kam punuar gjatë me Ramazanin, nis e tregon Petrit Rama. Edhe pse ishte mjaft i ditur në profesion ai nuk përtonte të pyeste shpesh edhe ne të tjerët, ish koleg e pse jo dhe mvartës të tij. Për Ramazanin nuk kishin mjaftuar vetëm vitet e shkollës që të përfitonte një kulturë dhe profesionalizëm të lartë por ai lexonte vazhdimisht literaturë shkencore. Kjo them me bindje e pregaditi që të ishte jo vetëm profesionist i mirë por dhe kuadër me përvojë. Shkonte shpesh edhe në shtëpitë e fshatit kur e kërkonin dhe u jepte ndihmën mjeksore falas. Këtë e bëri vite me radhë jo vetëm në Shumbat po në të gjitha vendet që ka punuar. Ishte i papërtuar dhe shumë i dhënë pas profesionit. Ramazanin do ta gjeje tek të gjithë e bisedonte jo vetëm për profesionin e tij. Kishte një kulturë të gjërë e dije dhe për fusha të tjera. Edhe unë kam patur fat të njihem nga afër me Ramazanin. Në ato vite sapo kishte ardhur me punë në fermën e Shumbatit e unë kur vija me leje qëndroja me orë të rëra me Ramazan Hoxhën. Bisedonim për letërsinë, për librat që botoheshin ato vite, për filmin dhe pikturën. Shkurt Ishte i gjithanshëm. Ramazani ishte njeri shumë i ndjeshëm, shumë i sinqertë dhe i dashur me të gjithë por urrente në maksimum servilizmin. -Servilizmi është pjellë injorancës dhe kështu dëmton rëndë ato që rreken natë e ditë mbi libra. Kishte të drejtë se edhe sot servilizmi është i pranishëm në shoqërinë tonë. Ai e kuptonte shumë mirë se jeta ishte e vështirë, se varfëria ishte ulur në vatrat tona por këtë e tregonte më së miri me heshtjen që tregonte. Heshtja e tij përpara shokëve e miqve fliste shumë në raste të vështira. Ai asnjëherë nuk u bashkua me njerëzit meskinë që sundonin kudo dhe servilët që i qëndronin shpesh nëpër këmbë. Kudo punoi me përkushtim për profesionin. E lidhi jetën e tij me këtë profesion që ndoshta në fillim dhe nuk e dashuroi siç duhej por rrethanat e dërguan të diplomohej në atë degë. Pas Shumbatit punoi në Kastriot e vitet e fundit dhe në Tiranë Kamëz. Sot pas kaq vitesh ka mjaft miq e shokë që flasin me respekt për intelektualin e kompletuar Ramazan Hoxha. Krahas profesionit Ramazani ishte i dhënë edhe pas sportit të mundjes ku disa herë doli dhe kampion me ekipe të ndryshme. Kështu në Korçë me ekipin e "Skëndërbeut" u shpall kampion republike për peshën e vet sa trajneri i ekipit të "Skëndërbeut" kërkoi me këmbëngulje që ta mbante në ekipin e mundjes së "Skëndërbeut" Jo vetëm njëherë por Ramazani shpallet kampion Republike me tre ekipe si "Skëndërbeu","Korabi" e" Partizani" por nuk e pati fatin e mirë që kishin mundësit e tjerë të ndeshej jashtë vendit tonë. Me siguri hija e vështirë e luftës së klasave ndikonte negativisht për këtë mundës që premtonte për shumë. Ramazani ishte një intelektual vizionar. Ai shikonte më larg se të tjerët. Pas viteve nëntëdhjet kur filluan të fryjnë erërat e demokracisë Ramazani nuk fantazonte por kërkonte më shumë ndaj vetes. Kështu u shkëput familjarisht nga fshati i tij i lindjes për të banuar në Tiranë qysh në vitin 1989, vit që për shumë veta ende mbetej si një ëndërr e pa realizuar. Kanë kaluar më shumë se tetë vite që Ramazan Hoxha nuk jeton. Nënë Arzja ende është gjallë. Shikon çdo ditë fëmijët e Ramazanit tashmë të rritur e të shkolluar dhe zemra i bëhet mal. Këtë dëshirë kishte dhe vetë Ramazani, një amanet ky që u realizua plotësisht vetëm tani pas vdekjes. Djali i madh Emiljani ka përfunduar për agro-biznes, Eltoni agronomi, Maksimi Akademinë e Edukimit Fizik e vajza e vetme informatikë. Një familje e madhe, një familje intelektuale që sot të gjithë bashkë me Limanin, vëllain e Ramazanit punojnë dhe drejtojnë shkollën jo publike "Sarina" , një shkollë kjo që bëri shpejt emër të mirë në shkollat private të vendit tonë.

Shaqir Skarra

Tel /Fax: +355 4 2253285 Cel: +355 68 4083244

EURO REKLAMA KORABI

- TABELA ME/PA NDRIÇIM,
- BANER
- BILLBOARD
- VESHJE AUTOMJETE & VETRATA
- ELEKTRONIKE, ETJ...

e-mail: euroreklama_al@live.com
Adresa: Rruga "Durrësit",
Blloku "Gintash",
Laprakë, Albania

RRUGA JUAJ
DREJT SUSKSESIT

Gazetën, falë ndihmës së z. Gazmend Kërkuti, mund ta lexoni edhe në internet në adresën: www.dibra.org